

Fjala e Ministrit

Fjala e DREJTORES se ZSHDA

E drejta e Autorit dhe te Drejtat e tjera te lidhura me te

Kuadri ligjor kombetar dhe nderkombetar

ZSHDA

(misioni , struktura organizative)

Marredheniet institucionale te ZSHDA me institucione te tjera shteterore

Hartimi i ligjit te ri per te drejten e autorit

Strategjia Kombetare Pronesise Intelektuale

Aktivitetit i ZSHDA

Regjistrim-Certifikimi dhe Inspektimi i Produktit Intelektual

Gjykimi Administrativ i Ankesave

Monitorimi i Agjensive te Administrimit Kolektiv

Marredheniet me Jashte dhe me Publikun

Shqiptarët janë një komb i lashtë e me një kulturë e traditë prodhimtarie intelektuale, që nuk shkon aspak për analogji me sipërfaqen territoriale që Shqipëria ka. Është pikërisht misioni ynë që kjo kulturë dhe prodhimtari intelektuale të zhvillohet, përhapet, promovohet e stimulohet, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit politikave efikase në funksion të repsktimit e mbrojtjes së produktit intelektual në Shqipëri.

Përgjatë viteve të tranzicionit, vendi ynë u përfshi nga vala e ndryshimeve të mëdha, duke hapur siparin me reformimin e strukturave administrative, por njëkohësisht edhe në vetëdijësimin e shoqërisë shqiptare dhe veçanërisht të sferave intelektuale, për përfshirjen në një proces të pandërprerë shndërrimesh si në sitemin e vendimarrjes ashtu edhe në atë ekzekutiv.

Institucionet e kulturës dhe komunitetet e krijuesve u gjendën përballë sfidave të mëdha, në përpjekje për t'u njehsuar me modelet që ofronin vendet evropiane. Pjesë e këtyre zhvillimeve dhe reformave, padyshim do të ishte dhe pronësia intelektuale dhe e drejta e autorit në vecanti.

Vetëdija për kompleksitetin e rëndësisë që mbartin të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, në zhvillimet kulturore, sociale, ekonomike e politike të një vendi e shoqërie, sot është arritur.

Ajo çfare mund te themi se kemi arritur këto vite të fundit është që tashmë është bërë e qartë që e drejta e autorit është një e drejtë morale dhe materiale si gjithë të drejtat e tjera, ajo është pronë e cila duhet respektuar, paguar dhe nuk preket. Zbatimi i saj, respektimi i produktit të mendjes të tjetrit, përdorimi i saj i drejtë dhe jo në mënyrë pirate, por në bazë të ligjeve, është një tregues i qartë i nivelit të civilizimit të një shoqërie.

Pronësia Intelektuale nuk duhet parë si një qëllim në vetvete, por si një instrument për arritjen e politikave të caktuara publike, për stimulimin dhe shpërndarjen e krijimtarisë.

Pronësia Intelektuale kombëtare, si pjesë e qënësishme e kulturës kombëtare, është dhe do të jetë në fokusin e Qeverisë Shqiptare dhe të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për të përmbushur misionin dhe objektivin e saj atë të vendosjes së kulturës në shërbim të mirëqënies, zhvillimit dhe integritimit europian të Shqipërisë dhe Shqiptarëve.

Ministri

Ferdinand Xhaferri

Ky është buletini i parë informativ i aktivitetit të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit. Botimi i këtij buletini është një detyrim ligjor i ZSHDA-së për të paraqitur aktivitetin e saj, si dhe për të siguruar si transparencën e punës së saj, ashtu edhe me qëllim promovimin e politikave dhe zhvillimeve sa i takon të drejtës së autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të.

Me lejoni shkurtimisht të bëj një përmbledhje të situatës ku ndodhemi aktualisht në vend dhe rrugës së përshkruar deri këtu. Kemi një ligj "Per te drejten e autorit dhe te drejtat qe lidhen me te" te aprovuar ne vitin 2005. Ky ligj është pjesërisht i përafuar me direktivat e BE. Bazuar në këtë ligj është ngritur gati pak më shumë se 2 vjet më parë institucioni i ri ZSHDA.

Ky institucion vinte për të garantuar dhe monitoruar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit në Shqipëri. Situata në Shqipëri paraqitet si një treg totalisht i pabindur karshi rregullave dhe standarteve europiane në fushën e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe pronësive intelektuale. Operatorët ekonomikë me të medhenj në vend, nuk paguanin detyimet që kishin karshi të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera fqinje me të. Për më tej përdorues të tjerë, madje as e konsideronin veten përdorues të produktit intelektual.

Eshtë dashur një periudhë e gjatë tryezash të rumbullaketa me të gjitha grupet e interesit, pjesëmarrje e eksperteve të zyrës neper takime, njoftime të herepashershme me ane të shkresave ku i ftonim për bashkëpunim dhe ku u shpjegonim dhe pozicionin e tyre ligjore në baze të ligjit, aksione të vazhdueshme të inspektorëve të zyrës të cilët vendosin masa ndërshkimore në raste e konstatimeve të shkeljeve të ligjit etj për të patur një panoramë modestisht të përmirësuar sot, por pa dyshim me të ndergjegjesuar.

Ajo çfarë sot kemi kuptuar dhe jemi të bindur që beteja e respektimit të të drejtës së autorit në Shqipëri është një betejë e cila nuk fitohet vetëm nga ZSHDA, sado e perkushtuar dhe profesionale ajo të jete. Është një seri institucionesh shtetërore, subjekte private, autorë e krijues, organizata mbajtëse –të të drejtave, t ekonomikë, opion publik, të cilët secili për pjesën takuese duhet të reagojnë e të veprojnë e bashkërendojnë me efektin zinxhir, në mënyrë që situata të përpirësohet e Shqipëria të klasifikohet edhe ë këtë fushë, mes vendeve europiane, vende ku standartet tashmë janë ktheur në norma të përditshme funksionimi.

Gjithësesi më duhet të theksoj e të përmend që situata e të Drejtës së autorit në Shqipëri ka pësuar ndryshime. Sot nuk flasim më për një term të huaj e të pakuptimtë si për autorët e krijuesit, të cilët nuk kanë qënë të informuar për të drejtat e tyre, ashtu edhe për komunitetin e biznesit, i cili ishte i vendosur në një situatë refuzuese e padije përsa i takon të drejtave dhe detyrimeve respektive që Ligji për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat që lidhen me të garanton.

Sot vullneti politik i Qeverisë Shqiptare, si një garanci solide për ndërhyrje emergjente në këtë fushë, është shprehur në përgatitjen e një Strategjie Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, dokument strategjik ky i cili do të përcaktojë objektivat dhe prioritetet afta-shkurtër e afat-gjatë të Qeverisë në këtë fushë, si dhe do të adresojë zgjidhje konkrete e masat përkatëse, të nevojshme për t'u marrë për një ndryshim të shpejtë e efektiv të situatës.

Ndërmjet problemeve të shumta që kjo fushë ka, vihen re dhe arritje. Për këto arritje do të doja të rreshtoja të gjithë aktorët dhe faktorët që kanë kontribuar në këtë proces që janë: Qeveria Shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale, Delegacioni i Komisionit Europian në Tiranë, Institucionet shtetërore dhe sidomos Drejtorinë e përgjithshme të tatimeve, Agjencitë e Administrimit Kolektiv “Albautor”, “Fma”, “Ami” dhe “Akdie”, dhe në fund por jo më pak stafin e ri të ZSHDA-së të cilët kanë kontribuar cdo ditë në ngritjen dhe formatimin e këtij institucioni të ri.

Ju faleminderit!

## **I. E DREJTA E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME TË**

### **(Informacion i përgjithshëm)**

**E drejta e autorit vjen nga një nocion i thjeshtë: njerëzit që krijojnë, prodhojnë ose investojnë në vepra krijuese mund të jenë të vetmit që vendosin se si kjo vepër mund të riprodhohet dhe të vihet në dispozicion të publikut.**

E drejta e autorit ruhet në ligjin ndërkombëtar për më shumë se 200 vjet. E drejta e autorit siguron bazën ekonomike për krijimin dhe shpërndarjen e veprave muzikore, letrare, artistike, filmat, programet kompjuterike dhe forma të tjera të veprave krijuese. E drejta e autorit mbron kulturën dhe edukon integritetin artistik.

E drejta e autorit siguron, që mbajtësit e të drejtës të përcaktojnë nëse dhe si të kopjojnë, shpërndajnë, transmetojnë dhe përdorime të tjera të veprave të tyre se si të zhvillohen. Kjo u jep njerëzve të talentuar stimul për të krijuar vepra të mëdha dhe sipërmarrësve, arsye ekonomike për të investuar në to.

E drejta e autorit është përforcuar në një histori të jashtëzakonshme moderne, ekonomike dhe të sukseshme, duke llogaritur 100 milion të vendeve të punës mbare botës. Rritja dramatike e industrive artistike, kulturore dhe e industrive të tjera krijuese në ditët e sotme rritja ekonomike mund të ketë qenë e pamundur pa nivelet e forta të mbrojtjes së të drejtës së autorit, që këto vende kanë zhvilluar për shumë dekada.

Shifrat më të fundit qeveritare të disponueshme në Europë dhe në USA e vlerësojnë industrinë e bazuara në të drejtën e autorit respektivisht në 360 billion euro dhe 340 billion US, duke përfaqësuar kështu më shumë se 5% të GDP. Ashtu sic hymë në epokën e tregtisë elektronike, materialet me të drejtë autori do të jenë një nga komoditetet më të vlerësuara për t'u ofruar dhe shitur gjithashtu online.

Legjislacioni i të drejtës së autorit është pjesë e një legjislacioni më të gjerë, i njohur si pronësi intelektuale. Termi pronësi intelektuale i referohet gjerësisht krijimeve të mendjes së njeriut. Të

drejtat e pronësisë intelektuale mbrojnë interesat e krijuesve duke ju dhënë atyre të drejtën e pronës mbi krijimet e tyre.

### *Dy Degët e Pronësisë Intelektuale janë Pronësia Industriale dhe e Drejta e Autorit*

Pronësia intelektuale zakonisht ndahet në dy degë, respektivisht pronësia industriale, e cila më gjerë thënë mbron shpikjet dhe e drejta e autorit, e cila mbron veprat letrare e artistike.

### **Të drejta të mbrojtura nga e drejta e autorit**

Parimi i çdo lloj prone është që pronari mund ta përdorë atë ashtu siç ai dëshiron dhe që askush tjetër, nuk është i legjitimuar ta përdorë pa autorizimin e tij. Kjo, padyshim, nuk do të thotë se ai mund ta përdorë pavarësisht të drejtave dhe interesave të anëtarëve të tjerë të shoqërisë. Po kështu pronari/mbajtësi i të drejtës së autorit i një vepre të mbrojtur mund ta përdorë veprën ashtu siç dëshiron dhe mund të ndalojë të tjerët ta përdorin pa autorizimin e tij. Të drejtat e mbajtësit të së drejtës të një vepre të mbrojtur, të garantuara në ligjet kombëtare, janë normalisht të drejta ekskluzive, për të autorizuar një palë të tretë për të përdorur veprën, subjekt i të drejtave dhe interesave të ligjshëm të të tjerëve.

Ka dy lloj të drejtash në të drejtën e autorit.

Të drejtat ekonomike lejojnë mbajtësin e të drejtave të përftojë shpërblime financiare nga përdorimi i veprës së tij nga të tjerët.

Të drejtat morale lejojnë autorin të ndërmarrë veprime të caktuara për të ruajtur lidhjen personale midis atij dhe veprës.

Shumica e ligjeve të të drejtës së autorit njohin se autori ose mbajtësi i të drejtës ka të drejtën të autorizojë ose të ndalojë veprime të caktuara në lidhje me veprën. Mbajtësi i të drejtave të një vepre mund të **ndalojë ose autorizojë**:

- riprodhimin e veprës në forma të ndryshme, siç janë publikimet e printuara dhe regjistrimet e tingujve;
- shpërndarjen e kopjeve;
- shfaqjen në publik;
- transmetimin e tyre ose çdo komunikim tjetër në publik;
- përkthimin e saj në gjuhë tjetër;
- përshtatjen, siç psh një novelë në skenar;

### **Të drejtat e lidhura me të drejtën e autorit**

Qëllimi i të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit është të mbrojë interesat ligjore të personave të caktuar dhe entiteve të legjitimuara (person juridik/fizik i regjistruar pranë organeve përkatëse) të cilët kontribuojnë për të vënë në dispozicion të publikut, veprat; ose kush prodhon subjektin e çështjes - të cilat ndonëse nuk përcaktohen si vepra sipas sistemeve të së drejtës së autorit të të

gjitha shteteve, përmbajnë krijimtari të mjaftueshme ose aftësi teknike dhe organizative për të justifikuar njohjen e të drejtës së autorit- si e drejtë e pronësisë.

Tradicionalisht, të drejtat e lidhura me të drejtën e autorit u janë akorduar tre kategorive të përfituesve:

- **Interpretuesve**
- **Prodhuesve të fonogramit;**
- **Organizatava transmetuese.**

### **Ç`eshte pirateria?**

Termi i piraterise është përdorur në përgjithësi për të përshkruar shkeljet apo mashtrimet të së drejtës së autorit, të bera me qëllim, në shkallë tregtare.

## **II. KUADRI LIGJOR I KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR I TË DREJTËS SË AUTORIT DHE TË DREJTAVE TË TJERA TË LIDHURA ME TË**

Mbrojtja e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në Shqipëri ushtrohet në përputhje me Instrumentat kombëtarë dhe ndërkombëtarë të mëposhtëm:

- 1) Kushtetuta (neni 58);
- 2) Konventat/ Marrëveshjet/ Traktatet ndërkombëtare ku aderon RSH-ja;
  - Konventa e Bernës “Për mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike”; nënshkruar në Bernë më 09.09.1886, plotësuar me Aktin e Parisit më 24.07.1971 dhe ndryshuar me 8 Shtator 1979; RSH ka aderuar në këtë Konventë, shpallur me dekretin nr.487, më datë 09.03.1993,” Për Aderimin e RSH në Konventën e Bernës” Për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike”.
  - Marrëveshja e TRIPS – “Mbi aspekte të caktuara tregtare që lidhen me të drejtën e autorit dhe te drejta të tjera të lidhura me të”; nënshkruar më datë 22.12.1995.
  - “Konventa Universale e Parisit për të Drejtën e Autorit“ dhe 2 protokollet shtesë të saj, nënshkruar në Paris më 24.07.1971.RSH ka aderuar në këtë Konventë, shpallur me Ligjin nr. 9129, datë 08.09.2003 “Për Aderimin e RSH në Konventën Universale të të Drejtës së Autorit dhe 2 protokollet shtesë të saj”.
  - Konventa Ndërkombëtare e Romës “Për mbrojtjen e Artsitëve Interpretues dhe Ekzekutues, Prodhuesve të Fonogrameve dhe Organizatave transmetuese” – nënshkruar më 26 tetor 1961. RSH ka aderuar në këtë Konventë,shpallur me ligjin nr. 8579, datë 16.02.2000 “Për

Aderimin e RSH në Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Artsitëve Interpretues dhe Ekzekutues, prodhuesve të Fonogrameve dhe Organizatave transmetuese”

-Konventa e “Mbrojtjes së Prodhuesve të Fonogrameve kundrejt riprodhimeve të paautorizuara të fonogrameve të tyre, nënshkruar më 29.10.1971. RSH ka aderuar në këtë konventë, me ligjin Nr. 8585, datë 15.03.2000.

-Traktati i OBPI “Mbi të drejtën e autorit” - 20 dhjetor 1996; RSH ka aderuar në këtë konventë, shpallur me ligjin Nr. 8838, datë 22.11.2001” Për aderimin e RSH në Traktatin e OBPI për të drejtën e autorit” .

-Traktati i OBPI “Për Interpretimet, Ekzekutimet dhe Fonogramet; RSH ka aderuar në këtë konventë, me ligjin Nr. 8740, datë 15.02.2001 “Për aderimin e RSh në Traktatin e OBPI-s, për Interpretimet, Ekzekutimet dhe Fonogramet”

3) Direktivat e EC në fushën e pronësisë intelektuale;  
(të transpozuar në Ligjin Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” - përputhshmëria e pjeshme).

- Direktiva 93/98/EEC mbi kohezgjatjen e mbrojtjes se te drejtes se autorit (amenduar në vitin 2006).
- Direktiva 91/250 /EEC mbi mbrojtjen e programave kompjuterike.
- Direktiva 2004/84 EEC mbi te drejten e vazhdimësisë të autorëve të veprave të arteve të bukura.
- Direktiva 92/100 /EEC mbi te drejtat e Huase dhe Qerase te lidhura me te drejten e autorit, 19 nentor 1992- (amenduar në 2006)
- Direktiva 93/98/EEC mbi Harmonizimin e kohezgjatjes se mbrojtjes se te drejtes se autorit dhe te drejtave te tjera te lidhura me te.
- Direktiva 93/83/EEC mbi Koordinimin e rregullave te caktuara qe lidhen me te drejtat e autorit dhe te drejta te tjera te lidhura me te.

4) Marreveshja e Asociim – Stabilizimit (MSA)- (neni 73);

5) Kodi Civil,

Kodi Penal (nenet 147, 148, 149),

Kodi i Procedurave Civile,

Kodi i Procedurave Penale,

Kodi i Procedurave Administrative.

- 6) Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.
- 7) VKM Nr. 232, datë 19.04.2006 “Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit”,
  - VKM Nr. 343, datë 6.6.2007 “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga ZSHDA” ( e ndryshuar)
- 8) Aktet ligjore e nënligjore organike përkatëse të institucioneve të administratës shtetërore që janë të përfshira në sistemin e mbrojtjes, respektimit dhe zbatimit të të drejtës së autorit, si:
  - Ligj Nr. 9920, datë 19.05.2008\_ “Per procedurat tatimore ne RSH”
  - Kodi doganor, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të tij.
  - Ligji 8410, date 30.09.1998 “Per radion dhe televizionin publik e privat ne RSH i ndryshuar
  - Ligji Nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për kinematografinë”, i ndryshuar
  - Ligj Nr. 9723, datë 03.05.2007 “ Për krijimin e QKR”
  - Ligj nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

### **III. ZYRA SHOIPTARE PËR TË DREJTAT E AUTORIT**

- ***STATUSI DHE OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË ZYRËS SHQIPTARE PËR TË DREJTAT E AUTORIT (ZSHDA)***
  - Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), është institucion qendror, me statusin e personit juridik publik, në varësi të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me seli në Tiranë. ZSHDA-ja ka vulën dhe logon e vet, të cilat miratohen nga titullari, në përputhje me vendimin nr.474, datë 10.7.2003 “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë”.
  - ZSHDA-ja e ushtron veprimtarinë në mbështetje dhe në zbatim të Kushtetutës, të legjislacionit shqiptar për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të në dispozitat e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe në konventat e marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.
  - ZSHDA-ja ka si objekt të veprimtarisë mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të



drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera, të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike, shkencore.

- **ZYRA RAJONALE E SË DREJTËS SË AUTORIT**

- Për përmbushjen e funksioneve, pranë çdo qarku, krijohen zyrat rajonale të së drejtës së autorit (më tej ZRDA), të cilat janë struktura në varësi administrative të ZSHDA-së. ZRDA-ja ka vulën dhe logon e vet, në përputhje me përcaktimin e bërë në pikën 1 të këtij vendimi, ku shtohen fjalët “Zyra rajonale për të drejtat e autorit dhe qarku...”.
- ZRDA-ja, nëpërmjet inspektorëve, kontrollon autorizimet dhe lejet përkatëse, të lëshuara nga autorët, titullarët e të drejtave të autorëve apo të agjencive të administrimit kolektiv, ndaj përdoruesve të pronësisë artistike, kulturore a shkencore, dhe vendosin gjobat, në përputhje me nenin 130 të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera, të lidhura me të”, brenda kufijve administrative të qarkut, ku ushtron veprimtarinë zyra rajonale e të drejtave të autorit.

- **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ZSHDA-SË**

- Shqyrton dhe regjistron çdo aplikim për regjistrim të së drejtës së autorit dhe të drejtave, të lidhura me të, për subjektin aplikues, autor apo titullar i të drejtave të autorit mbi një vepër.
- Depoziton të gjitha aplikimet, regjistrimet dhe ndryshimet e të drejtave të autorit, të cilat i mban në bazën e të dhënave, që administrohen në Regjistrin e të Drejtave të Autorit, një regjistër ky dokumentar dhe elektronik.
- Certifikon çdo marrëveshje apo kontratë, të lidhur dhe/apo të ndryshuar, ndërmjet palëve, subjekte të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, ku objekt i kontratës janë të drejtat mbi veprën dhe/ose kalimin e të drejtave pasurore mbi veprën, në rast përdorimi, shfrytëzimi, riprodhimi, shpërndarjeje apo përcjelljeje në publik, në përputhje me nenet 45/1, 47 e 51/3. Për zbatimin sa më efektiv të këtij ligji pranë ZSHDA-së, regjistrohen dhe certifikohen të gjitha kontratat për kalimin, në formën ekskluzive, të të drejtave pasurore mbi një vepër, të çfarëdolloji, duke i pajisur **me pullën artistike** të gjitha kopjet e veprave, të cilat janë rezultat i riprodhimit nga një kopje origjinale.
- Ofron shërbime të specializuara, kundrejt tarifave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për çdo subjekt të interesuar, bën ekspertizën dhe jep vlerësimin me shkrim për çdo rast konflikti ndërmjet palëve, që kanë objekt të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të.

- Përcakton, me kërkesë të autorit, shpërblimin për kalimin e të drejtave pasurore mbi veprën, ndërmjet autorit dhe/ose titullarit të të drejtave të autorit dhe palës tjetër kontraktuese, sipas objektit të kontratës, në rast se ky shpërblim nuk është parashikuar shprehimisht në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, sipas neneve 34/2 e 68/3 të ligjit në fuqi.
- Shqyrton dhe jep shpjegim përfundimtar, me shkrim, për kërkesën e autorit, për veprën që pretendohet se është përdorur, shfrytëzuar, ndryshuar, riprodhuar, shpërndarë apo përcjellë në publik, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.
- Shqyrton mosmarrëveshjet për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të në përputhje me nenin 104 të ligjit.
- Cakton ekspertët e së drejtës së autorit pranë organeve gjyqësore, sipas fushave përkatëse, mbështetur në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.
- Mbikqyr veprimtarinë dhe zbatimin e detyrimeve ligjore të agjencive të administrimit kolektiv të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të dhe nëse vëren shkelje të detyrimeve ligjore, vepron në përputhje me nenin 116 të ligjit.
- Shqyrton kërkesat e të interesuarve për t’u licencuar në fushën e administrimit kolektiv të së drejtës së autorit, bën kontrollin e dokumentacionit të paraqitur, zhvillon hetim të plotë administrativ dhe i paraqet Ministrin të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dosjen e aplikantit, relacionin dhe mendimin e vet për përmbushjen ose jo të kushteve për t’u pajisur me licencë, në përputhje me nenin 108 të ligjit.
- Rregullon dhe certifikon çdo kontratë të lidhur ndërmjet autorit/autorëve apo titullarit/ve të të drejtave të autorit dhe agjencisë së administrimit kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të.
- Vendos pullën artistike të ZSHDA-së dhe depoziton një kopje origjinale të mbajtësit fonografik/videogramit, ose të mjetit të ngjashëm me të, për riprodhimin e tyre si dhe ushtron kontroll për respektimin e të drejtave të autorit, e prodhuesve apo shpërndarësve të kopjeve të autorizuara të fonogrameve, në përputhje me nenin 60 të ligjit.
- Bashkëpunon me organet tatimore, doganore, gjyqësore dhe me institucionet e tjera publike, si dhe me organizatat private, që përfaqësojnë përdoruesit e ndryshëm të pronësinë artistike, kulturore dhe shkencore për ato çështje që paraqesin interes të përbashkët për mënyrën e respektimit dhe të zbatimit të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- Vendos marrëdhënie bashkëpunimi me organizata të ndryshme dhe institucione homologe jashtë vendit.

- Propozon për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore, në fushën e së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të dhe ia paraqet Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
- Boton buletin periodik, ku jep informacione, analiza, studime dhe çështje të tjera të së drejtës së autorit dhe vë në dijeni publikun nëpërmjet *ëeb site*-it për veprimtarinë dhe misionin që ka në fushën e të drejtave të autorit

#### □ STRUKTURA DHE ORGANIKA E ZSHDA-SË

- Struktura dhe organika e ZSHDA-së miratohen me urdhër të Kryeministrit dhe me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
- Titullari i ZSHDA-së është drejtori i kësaj zyre. Ai drejton veprimtarinë e ZSHDA-së në përputhje me këtë vendim dhe me kërkesat e ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët.
- Emërimi, lirimi dhe shkarkimi nga detyra i drejtorit të zyrës bëhen në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat e përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirim ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.
- Kandidati, që konkurren apo emërohet në detyrën e drejtorit të ZSHDA-së, nuk duhet të ketë konflikt interesi në kuptim të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
- Marrëdhëniet juridike të punës, të drejtat dhe detyrimet, si dhe procedurat e rekrutimit të nëpunësve të ZSHDA-së mbështeten në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe në aktet e tjera nënligjore në fuqi.

#### • ORGANIZIMI FINANCIAR

- ZSHDA-ja është institucion buxhetor. Buxheti i zyrës miratohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve menjëherë pas miratimit nga Kuvendi të ligjit për buxhetin vjetor.
- ZSHDA-ja siguron të ardhura nga ofrimi i shërbimeve të specializuara, që ofron ndaj subjekteve të ndryshme, sipas tarifave të miratuara për këto shërbime, me vendim të Këshillit të Ministrave dhe i përdor ato në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, në fuqi.
- ZSHDA-ja mund të marrë dhurime dhe financime nga organizma brenda dhe jashtë vendit, që nuk vendosin detyrimin për kthimin e tyre, të cilat hyjnë në buxhetin e zyrës dhe

përdoren në përputhje me destinacionin e dhënë.

#### **IV. BASHKËPUNIMI I ZYRËS SHQIPTARE PËR TË DREJTAT E AUTORIT ME INSTITUCIONE TË TJERA SHTETËRORE**

##### **AKT-MARRËVESHJET E NËNSHKRUARA**

- **Memorandum Mirëkuptimi** nënshkruar midis Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i cili konsiston në: përcaktimin e modaliteteve, instrumentave dhe mënyrave të bashkëpunimit për implementimin e ligjit Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura”, me qëllim vendosjen e kontrollit mbi tregun e pronësisë së produktit intelektual në fushën e artit, kultuës dhe shkencës, si dhe për të garantuar respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura, duke forcuar luftën kundër piraterisë. Në kuadër të bashkëpunimit DPT angazhohet të zbatojë procedurat e vjeljes së gjobave të vendosura nga ZSHDA kundër subjekteve informale, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në prodhim, shpërndarje, shitje, transmetim apo përcjellje në publik në çdo formë dhe pa titull të ligjshëm të produktit intelektual.
- **Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi** i nënshkruar midis Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit, i cili konsiston në detyrimin e dy institucioneve për të shkëmbyer informacion dhe të dhëna në një kohë të shkurtër, për të gjitha rastet që kanë të bëjnë me luftën kundër piraterisë dhe, fallsifikimeve si dhe të respektimit të të drejtave të autorit. KKRT është institucioni i cili monitoron veprimtarinë e operatorëve RTV publikë e privatë, për transmetimet e programeve të veta, apo të blera nga palë të treat, duke respektuar të drejtat e transmetimit. Nga ana tjetër, sipas edhe memorandumit të bashkëpunimit me ZSHDA do të duhej të verifikonte dhe të kërkonte paraprakisht që programet që do të transmetoheshin nga këto operatorë ishin certifikuar në ZSHDA, dmth që ishte paguar e drejta e shfrytëzimit ndaj agjensive të aministrimit kolektiv, të cilat janë titullare të menaxhimit të këtyre të drejtave për veprat e transmetuara nga organizata transmetuese, sic është e përcaktuar edhe në LDA.
- **Memorandum Bashkëpunimi** i nënshkruar midis Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit dhe Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, i cili konsiston në: institucionalizimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, në përmbushje të detyrimeve ligjore të ndërsjellta në fushën e mbrojtjes së të drejtave të autorit, si dhe forcimin e luftës kundër piraterisë. QKK informon ZSHDA për listën e subjekteve fizikë apo juridikë të cilët lidhin kontrata me QKK për transmetimin, apo shpërndarjen e Filmit Artistik Shqiptar dhe këto kontrata regjistrohen në ZSHDA. ZSHDA informon QKK mbi Agjensitë e liçensuara të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit në fushën e artit dhe kinematografisë, të regjistruara në ZSHDA.
- **Memorandum Bashkëpunimi** i nënshkruar midis Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i cili konsiston në: në përcaktimin e

modaliteteve, instrumentave dhe mënyrave të bashkëpunimit në luftën kundër fallsifikimit dhe piraterisë së pronësisë të prodhimit intelektual në fushën e artit, kulturës dhe shkencës në zbatim të ligjit Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura”. ZSHDA informon periodikisht DPD mbi listën e subjekteve të regjistruar si titullmbajtës të ligjshëm për importimin/eksportimin e produkteve objekt i së drejtës së autorit. DPD në zbatim të detyrave funksionale, nëse ka dyshime mbi vërtetësinë e dokumentave të paraqitur i kërkon ZSHDA-së informacion apo ekspertizë sipas rasteve specifike.

- **Memorandum Mirëkuptimi** i nënshkruar midis Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe Autoritetit të Konkurrencës, i cili konsiston në: Shkëmbimin e informacionit zyrtar dhe çdo të dhëne tjetër në zbatim të ligjeve organike të dy institucioneve dhe në përmbushje të detyrimeve të këtij Memorandumi dhe detyrimeve të tjera ligjore reciproke.

## V. LIGJ I RI PER TE DREJTËN E AUTORIT

Që prej fillimit të këtij viti ka filluar punën grupi i punës për hartimin e Ligjit të ri për të Drejtën e Autorit. Ky ligj pritet të përmirësojë në këto drejtime:

- Garantimin sa më të mirë të të drejtave të autorit dhe të **drejtave të tjera të lidhura me të**.
- **Fuqizimin e rritjen e mekanizmave shtetërorë kontrollues**, monitorues dhe ndëshkues, si edhe **vendosjen e “filtrave” e masave sa më efektive**, ndaj subjekteve importues, eksportues, prodhues, përdorues apo shfrytëzues të veprave artistike, kulturore e shkencore.
- **Përcaktimin e detyrave dhe procedurave** ligjore-administrative të cdo institucioni shtetëror, si edhe ndërveprimin me njëri-tjetrin, në mënyrë që zinxhiri institucional të funksionojë sa më eficient dhe në afate kohore sa më të shkurtra, në funksion të realizimit të qëllimit që ka ky projektligj.
- **Parashikim** më të gjerë dhe saktësim të rasteve që përbëjnë kundërvajtje administrative, penale, apo vepra penale, dhe për rrjedhojë edhe **rritjen e vlerave dhe masës së sanksioneve ndëshkuese**.

**Draft-Ligji i ri mbi të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të**, drafti i të cilit së shpejti pret të bëj raundin e parë të konsultimeve, për afron edhe këto akte komunitare:

1. Direktiva e Këshillit të Europës **2004/48/EC** e Parlamentit European dhe e Këshillit të datës 29 Prill 2004 “*Mbi forcimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale*”,
2. Direktiva **2001/29/EC** e Parlamentit European dhe Këshillit të Europës 22 Maj 2001 “*Për harmonizimin e disa aspekteve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, mbi shoqëritë e informacionit*”
3. Direktiva e Këshillit të Europës **2001/84/KE** e Parlamentit European dhe e Këshillit të 27 Shtatorit 2001 “*Mbi të drejtën e rishitjes për përfitimin e autorit të nje vepre origjinale arti*”
4. Direktiva **2006/115 /EC**- e drejta e huase dhe qerases lidhur me te drejten e autorit ne fushen e PI, e cila amendon Direktivën **92/100/EEC**;

5. Direktiva e 2006/116/EC- “Mbi kohezgjatjen e mbrojtjes se te drejtes se autorit dhe te drejtave te tjera te lidhura me te”, e cila amendon Direktivën 93/98/EEC

## **VI. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR PRONËSINË INTELEKTUALE**

**Objekti i Strategjise se Pronwsisw Intelektuale nw Shqipwri wshtw zhvillimi i njw Sistemi tw Pronësisë intelektuale dhe industriale qw tw garantojw sigurimin e mbrojtjes së përshtatshme dhe efikase dhe të zbatimit të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale.**

Qwllimet e Qeverisw sw Republikws sw Shqipërisë të cilat synohen tw arrihen me anë të kësaj Strategjie Kombëtare janë:

1. Pwr tw garantuar (brenda njw kohe tw shkurtwr) nivel të njëjtë mbrojtjeje tw tw drejtave tw pronwsisw intelektuale me ato ekzistuese nw Komunitetin European, si dhe garantimin e vazhdueshëm të harmonizimit të nivelit të mbrojtjes nw pwrputhje me tw gjitha detyrimet ndwrkombwtare dhe marrwveshjet që Republika e Shqipërisë është palë
2. pwr tw siguruar (brenda nje periudhe afat mesme) pwrmirwsimin e pwrdorimit/ushtimit te pronwsisw intelektuale si njw mjet i fuqishem pwr rritjen ekonomike dhe njw nxites i progresit ekonomik, shkencor, kulturor dhe social nw pwr gjithwsi pwr tw arritur nivelin e pwrdorimeve tw tilla nw EU.

Strategjia do tw mbulojw njw periudhw pesw-vjecare dhe do tw shtrihet nga viti 2010 nw vitin 2015. Kjo periudhw kushtwzohet nga situata aktuale na fushën e pronësisë intelektuale, e cila dikton marrjen e masave tw shpejta dhe komplekse, te cilat do e reformojnw sistemin nw twrwsia dhe qw nuk mund tw shtrihen nw njw afat tw gjatw kohor, dhe pwr shkak tw zhvillimeve tw shpejta dhe të pandalura në këtë fushë, nga zhvillimet marramendëse të teknologjive të informacionit, të cilat kanë nevoje për një sistem efikas, të aftë për të absorbuar dhe zbatuar politika të zhvillimit ekonomik, social por edhe kulturor.

### **□ QËLLIMET e KËSAJ STRATEGJIE DO TË ARRIHEN NËPËRMJET REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË MËPOSHTËM**

- Adaptimi dhe harmonizimi i legjislacionit kombwtar nw fushwn e pronwsisw intelektuale me kwrkesat e ligjit tw komunitetit dhe pwrshatjen e rregulloreve kombwtare me marrwveshjet ndwrkombwtare nw tw cilat Shqipwria wshtw pjesw.
- Intensifikimin e implementimit nw Shqipëri tw legjislacionit nw fushwn e pronwsisw intelektuale.
- Ndwrtimi i njw infrastrukture tw mirwfilltw administrative brenda institucioneve kombwtare tw pwrfskira nw sistemin kombëtar për sigurimin e mbrojtjes sw pronwsisw intelektuale.

- Zhvillimin e burimeve njerwzore tw specializuara nw fushwn e pronwsisw intelektuale.
- Arritjen e nje bashkwpunimi transparent midis institucioneve dhe organizatave te pwrfsHIRA ne garantimin e mbrojtjes sw pronwsise intelektuale.
- Rritjen e shkalles sw informimit dhe trajnime te publikut nw fushwn e pronwsise intelektuale dhe rendesine e te drejtave mbi pronesine intelektuale.

## VII. AKTIVITETI I ZSHDA-SË GJATË VITETE 2007-2009

### □ Inspektimi dhe Regjistrim-Certifikimi i Produktit intelektual

Në vështrimin e parë të emërtesës së Sektorit të Inspektim dhe Regjistrim-Certifikimit, kuptohet qartë edhe misioni i kësaj strukture të ZSHDA-së, si dhe detyrat e përgjegjësitë, të cilat burojnë nga dispozitat e ligjit 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me të” si dhe të Vendimit nr. 232, datë 19.04.2006 “Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit”.

E në këtë kuptim, dy janë drejtimit kryesore ku konsiston puna e këtij Sektori:

Së pari, inspektimi nëpërmjet monitorimit të subjekteve të ligjit, të cilët gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre private a publike shfrytëzojnë a përdorin produkt artistika kulturor të mbrojtur me të drejta autori dhe të drejta të lidhura me të, dhe **sa të ligjshëm** janë këto subjekte në përdorimin e **Autorizuar** të veprave artistike, kulturore dhe shkencore, përfshirë edhe zbatimin e detyrimeve të tjera që burojnë nga LDA.

Në lidhje me ushtrimin e këtyre kompetencave, Inspektorët kontrollojë subjektet e ligjit për:

a-Regjistrimin dhe certifikimin e objektit të veprimtarisë së tyre tregtare ose jo, në bazë të nenit 130, pika 1 të LDA;

b-Leje-Autorizimin nga Mbajtësi i së drejtës apo Agjencitë e Administrimit Kolektiv të të drejtave të autorit dhe/ose të drejtave të lidhura me të;

c-Kontrollin për pajisjen me Pullën Artistike të ZSHDA-së, të fonogrameve të hedhura në treg me të drejta të plota dhe titull të ligjshëm, detyrim që buron nga neni 60 i LDA.

**Së dyti**, regjistrimi dhe certifikimi i të drejtave që subjektet e ndryshëm të ligjit persona fizikë a juridikë, gëzojnë si mbajtës të të drejtave apo si titullarë përfitues të këtyre të drejtave, të kaluar me anë të kontratave/marrëveshjeve, leje-autorizimeve, deklaratave apo dhe veprimeve të tjera juridike të vlefshme, që lejojnë certifikimin e titullarëve të së drejtës.

Këtu do të ndaleshim pak, për të sqaruar se përvec regjistrim-certifikimit të kontratave me objekt kalim të drejtash, ligji LDA në pikën 1 të nenit 130 të tij, përcakton se pavarësisht pasjes ose jo të një titulli të ligjshëm për përdorimin/shfrytëzimin e autorizuar nga mbajtësi i së drejtës, në lidhje me veprat e shfrytëzuara, këto subjekte duhet të regjistrojnë dhe certifikojnë paraprakisht në ZSHDA objektin e veprimtarisë së tyre, edhe nëse shfrytëzimi i veprave artistike, kulturore etj., përbën aktivitet primar apo sekondar i subjektit.

Për sa më sipër dhe në funksion të përmbushjes së detyrave ZSHDA, nëpërmjet SIRC, administrohet edhe Regjistri i të Drejtës së Autorit sipas klasave administrative, i cili është Baza e të Dhënave për cdo aplikim që regjistrohet, regjistrohet dhe certifikohet, apo refuzohet, të dhena të

cila indeksohen dhe përditësohen nga ky sektor. Përveç këtyre klasave në RDA ka një klasë më vete për Agjencitë e Administrimit Kolektiv të licensuara për të ushtruar aktivitetin e tyre në fushën e menaxhimit , mledhjes dhe shpërndarjes së shpërblimeve për autorët dhe titullarët e të drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të.

Në këtë aspekt ZSHDA mund të konsiderohet si “Hipoteka e Pronësisë Intelektuale e të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të lidhura me të”

#### ❖ **INSPEKTIMI:**

Bazuar në nenin **58 dhe 122 të Kushtetutës të Shqipërisë**, legjislacionit në fuqi, ligjit nr. 9380 datë 28.04.2005 “Për të drejtën e Autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të”, veçanarisht nenit **73 të Marrëveshjes së Asocim-Stabilizimit**;

Në bazë të kompetencave që na jep neni 131 i **ligjit nr. 9380 datë 28.04.2005. “Për të drejtën e Autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të”**, kap, VIII, pika 52 e **VKM, Nr. 232, datë 19.4.2006. “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS SHQIPTARE PËR TË DREJTAT E AUTORIT”** (ZSHDA), si dhe në bazë të kap III, pika 2 të **Rregullores së Brendshme të Zyrës Shqiptare Për të Drejtën e Autorit**,

Në zbatim të **Urdhërit Zyrtar të titullares së Instutucionit**;

qëllimi i të cilit është konstatimi në teren i zbatueshmërisë së ligjit nga subjektet prodhues dhe përdorues të produktit intelektual.

Në bazë të nenit 60 LDA ndalohet çdo tregtim, shitje apo shpërndare të nje produkti të regjistruar në fonograme, që nuk është pajisur me pullë.

#### **Neni 60**

#### **Kushtet dhe kriteret e shpërndarjes së fonogramave**

1. Shpërndarja e kopjeve të autorizuara të regjistrimeve fonografike ose të ndonjë pajisjeje tjetër të ngjashme për riprodhimin e tingujve a të zërave, ku është regjistruar një vepër e autorizuar, lejohet vetëm nëse ato përmbajnë, detyrimisht, elementet treguese të mëposhtme:

- a) Titullin e veprës së riprodhuar;
- b) Emrin e autorit;
- c) Emrin e artistit interpretues dhe/ose ekzekutues. Grupet orkestrale osekorale identifkohën me emrin e tyre artistik;
- ç) Datën e prodhimit;
- d) **Pullën artistike të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, të pakonsumuar;**
- dh) Shenjën “P” të prodhuesit, fiksuar pazgjidhshmërisht në mbajtës.



2. E drejta e shpërndarjes, e përcaktuar në këtë kapitull, mund të ushtrohet vetëm nëse një kopje e mbajtësit fonografik ose e mjetit tjetër të ngjashëm me të për riprodhimin e tingujve ose të zërave depozitohet në Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit, në përputhje me rregulloren e kësaj zyre.

Në bazë të shkeljes së konstatuar në Subjektin përkatës të përcaktuar në nenit 60/d, kundrejt subjekteve që hedhin produkt pa pullë në treg, mirret masë adm sipas nenit **130/1 pika g** si më poshtë:

**Seksion III**  
**Kundërvajtjet administrative**  
*Neni 130*  
**Kundërvajtjet administrative**

1. Përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas pikës 2, të këtij neni, veprimtaria e çdo personi, i cili nuk ka regjistruar dhe certifikuar paraprakisht objektin e veprimtarisë së vet në Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit, pavarësisht nga gëzimi ose mosgëzimi i një titulli të ligjshëm për kryerjen e tyre, që:

...

g) prodhon, shet, jep hua ose me qira videokaseta, audiokaseta ose çdo lloj mbajtësi tjetër, që përmban fonograme ose videograme të veprave kinematografike a audiovizuale, apo sekuenca të pamjeve të lëvizshme, të cilat **nuk janë të pajisura me pullën artistike të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, në bazë të një lejeje për ushtrimin e veprimtarisë tregtare;**

**Dhe ndëshkohet me gjobë sipas nenit 130/2, pika ç, si më poshtë,**

2. Kundërvajtjet administrative të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, dënohen me gjobë si më poshtë vijon:

...


ç) për rastet e parashikuara në shkronjat "e", "ë" "f" dhe "g", **me gjobë nga 10 000 lekë deri në 500 000 lekë;**

**Viti 2007**

**Tabelë Përmbledhëse të masave adm. të marra në subjektet  
përdorues/prodhues/shpërndarës të pronësisë artistike  
gjatë vitit 2007**

<b>Subjekte</b>	<b>Botues</b>	<b>Radio</b>	<b>Tv./operatorë kabllore</b>	<b>Hotel</b>	<b>Vidio teka ose pikë shitje</b>	<b>Bar kafe</b>	<b>Prodhues/etj</b>	<b>Nr.</b>
<b>Muaji</b>								
Gusht	2	0	0	0	0	0	1	3

Shtator	<b>0</b>	0	0	0	<b>0</b>	5	<b>0</b>	<b>5</b>
Total	2	0	<b>0</b>	0	<b>0</b>	5	1	<b>8</b>




### Viti 2008

**Tabelë Përmbledhëse të masave adm. të marra në subjektet përdorues/prodhues/shpërndarës të pronësisë artistike gjatë vitit 2008**

<b>Subjekt e</b>	Botues	Radio	Tv./operat orë kabllorë	Hotel	Vidio teka	Bar kafe	Prodhues/etj	Nr
<b>Muaji</b>								
Janar	0	0	0	0	<b>3</b>	0	<b>2</b>	<b>5</b>
Shkurt	0	0	0	0	<b>16</b>	0	<b>1</b>	<b>17</b>
Mars	0	0	0	0	0	0	0	<b>0</b>
Prill	0	0	<b>1</b>	<b>6</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>7</b>	<b>22</b>
Maj	0	<b>4</b>	<b>16</b>	<b>1</b>	<b>17</b>	0	0	<b>38</b>

Qeshor	0	5	0	0	0	0	0	5
Korrik	0	0	0	0	0	0	1	1
Gusht	0	0	0	0	0	0	5	5
Shtator	0	0	0	0	0	0	1	1
Tetor	1	0	0	0	0	0	0	1
Nëntor	0	3	0	0	0	0	0	3
Dhjetor	0	1	0	0		0	0	1
Total	1	13	17	7	41	3	17	99

**Tabelë ilustruese, 2008**



**Në subjektet e inspektuara në qytetet Tiranë, Durrës dhe Fier, rezulton se janë konstatuar shkelje administrative dhe janë marre**

**masa me gjobë në këta përdorues/shpërndarës të pronësisë artistike të emërtuar si më poshtë në tab.**


**1:**

**Tabelë Përmbledhëse të masave adm. të marra në subjektet përdorues/prodhues/shpërndarës të pronësisë artistike**

**gjatë vitit 2009**


<b>Subjekte</b>	<b>Botues</b>	<b>Radio</b>	<b>Tv./opera torë kabllorë</b>	<b>Hotel</b>	<b>Vidio teka ose pikë shitje</b>	<b>Bar kafe</b>	<b>Prodhues/ etj</b>	<b>Nr</b>
<b>Muaji</b>								
Janar	0	0	0	0	<b>15</b>	0	0	<b>15</b>
Shkurt	<b>2</b>	0	0	0	0	0	0	<b>2</b>
Mars	0	0	<b>11</b>	0	<b>5</b>	0	0	<b>16</b>
Prill	0	0	0	0	<b>5</b>	0	<b>3</b>	<b>8</b>
Maj	0	0	0	0	<b>3</b>	0	0	<b>3</b>
Qeshor	0	0	0	0	<b>5</b>	0	0	<b>5</b>
Korrik	<b>1</b>	0	0	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	0	<b>8</b>
Gusht	0	0	0	<b>3</b>	0	0	0	<b>3</b>
Shtator	0	0	0	0	0	<b>13</b>	0	<b>13</b>
Tetor	0	<b>2</b>	<b>12</b>	0	0	<b>36</b>	0	<b>50</b>
Nëntor	0	0	0	0	0	<b>22</b>	0	<b>22</b>
Total	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>23</b>	<b>6</b>	<b>34</b>	<b>74</b>	<b>3</b>	<b>14 5</b>

**Tabela ilustruese, 2009**



**Grafik i pergjithshem:**

Viti	Nr i masave administrative
2007	<b>8</b>
2008	<b>99</b>
2009	<b>145</b>
<b>Total</b>	<b>252</b>



## **Ekzekutimi i Gjobave!**

Në bazë të LDA, pas kalimit të afatit të ankimimit, masa e vendosur ndaj subjekteve, përbën titull ekzekutiv dhe duhet të ekzekutohet nga organet tatimore. Konkretisht parashikuar në **nenin 131 të ligjit nr. 9380 datë 28.04.2005 “Për të drejtën e Autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhra me të”**.

### **Neni 131**

#### **Inspektorët e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit**

1. Dënimi me gjobë për kundërvajtjet administrative vendoset nga inspektorët e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, në juridiksionin e të cilëve është kryer kundërvajtja administrative, ***dhe ekzekutohet nga organet tatimore përkatëse.***
2. Ndaj dënimit me gjobë për kundërvajtjen administrative, të parashikuar në këtë ligj, bëhet ankim brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të gjobës.

#### **Tabele përmbledhese për Konfiskimin:**

<b>Vidioteka, pika shitje</b>	<b>Sasia e CD dhe DVD të konfiskuara</b>
<b>Viti 2008</b>	<b>4000 copë</b>
<b>Viti 2009</b>	<b>5053 copë,</b>

E drejta e autorit është një e drejtë individuale private e cila mbrohet nga vetë ata në mënyrë individule apo kolektive nga agjensitë e administrimit kolektiv të zgjedhur në mënyrë të vullnetshme prej tyre. Sipas këtij parimi universal, detyra e institucioneve shtetërore është hartimi i një baze ligjore të mirë për mbrojtjen e këtyre të drejtave si dhe mbështetja, organizimi dhe koordinimi i gjithë aktorëve që veprojnë zinxhir në këtë proces..

#### **Probleme:**

Intensifikimin e zbatimit të ligjit kundër piraterisë dhe falsifikimeve (në bashkëpunim me KKRT dhe Drejtorinë e Tatimeve).

Zbatimin e konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, për të drejtën e pronësisë intelektuale, tregtare dhe industriale.

Zbatimin në mënyrë të përshtatshme të drejtës së pronësisë intelektuale duke shënuar hapa konkrete në fushën kundër piraterisë.

Pavarësisht për sa më sipër, problemet kryesore të identifikuara në realitetin shqiptar për dhjetëvjeçarin e fundit janë dhe mbeten:

Pamjaftueshmëria e njohjes dhe zbatimit të ligjit “Për të drejtën e autorit;

Ndërgjegjësimi i operatorëve ekonomikë në lidhje me njohjen ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri është ende i ulët (Cka pas sjell mosrespektim dhe mospagimin e të drejtës së autorit për veprate përdorura në treg)

Nxitja dhe forcimi i luftës kundër piraterisë dhe fallsifikimit në nivel mjaft të ulët (mungesa e bashkëpunimit institucional dhe veprimi i kufizuar i organeve shtetërore të ngarkuara me ligj).

Koordinimi i veprimtarisë institucionale në luftën kundër piraterisë dhe fallsifikimit jo në nivelin e duhur.

Rritja e sensibilizimit të autorëve dhe gjithë kategorive të përfituesve të të drejtave, përdoruesve të veprave artistike, si dhe të shoqatave të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit, mbi problemet dhe shqetësimet e tyre jo në shkallën e duhur...

Zshda që me krijimin e saj ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme tregun e pronësisë artistike nëpërmjet Inspektorëve të vet e cila ka konsistuar në:

- 1- Informimin e subjekteve për ligjin Nr.9380, Dt.28.04.2005 “Për të Drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” si dhe detyrimin që subjektet përdorues të pronësisë artistike kanë nga ky ligj.
- 2- Vendosja e masave administrative me gjobë subjekteve të cilët kanë shkelur këtë ligj.

ZSHDA informimin e subjekteve e ka realizuar në qarqe të ndryshme të Shqipërisë (**Tiranë, Durrës, Fier, Pogradec, Korçë, Elbasan, Shkodër, Vlorë**) ku ka ndëshkuar dhe subjektet që kanë kryer kundravajtjet administrative. Më konkretisht:

ZSHDA ka vendosur gjatë periudhës **2007-2008-2009 në total 250 gjoba** të cilat ju janë vendosur përkatësisht subjekteve me objekt veprimtarie të ndryshme si më poshtë:

**(Prodhues fono/videogramesh, pika tregëtimi fono/videogramesh, Radio, Televizione, Ritransmetues kabllorë, Shtëpi Botuese, Hotele, Bar-Kafe, Restorante)**

**Viti 2007 - 7 Gjoba**

**Viti 2008 - 99 Gjoba**

**Viti 2009 - 144 Gjoba (Nëntor 2009)**

Nga inspektimi dhe monitorimi që kanë kryer Inspektorët e ZSHDA, është vënë re një indiferencë ndaj ligjit nga ana e subjekteve shfrytëzues/përdorues të pronësisë artistike, mosnjohja e ligjit nga një pjesë e subjekteve ka sjellë një mungesë totale të përmbushjes së detyrimeve, e cila ka qënë një

pengesë për aplikimin e menjëhershëm të sanksioneve nga ana e inspektoriatit të ZSHDA, i cili në subjektet të cilët nuk kanë pasur informacion ose kanë deklaruar sikur nuk kanë pavarësisht se indirekt kanë marrë dënim nga institucionet bashkëpunuese me ZSHDA, kanë dhënë informacion të detajuar mbi detyrimet që kanë subjektet ndaj ligjit.

Problemi tjetër dhe nga më kryesorët i hasur nga inspektorët janë dhe qendrat e internetit të cilat kanë vështirësi në kontrollin e tyre pasi te ta nuk egziston produkti intelektual si mall fizik por krijohet dhe realizohet me porosi, në bazë të kapacitetit të saj ZSHDA i ka informuar këto qendra dhe në rastin kur do ti evidentojë do të aplikojë sanksionet përkatëse në këtë fazë ku ndodhemi sot janë duke u menduar dhe duke u konsultuar me ekspertë përkatës se si mund të realizohet kontrolli dhe ndalimi i piraterisë në këto subjekte, pasi nuk duhet të cënohet biznesi i tyre.

Nga monitorimi i ZSHDA por edhe na sanksionet e vendosura, është vënë re një angazhim në zbatimin e ligjit nga ana e operatorëve ritransmetues kabllorë të cilët pas sanksioneve të vendosura kanë filluar të jenë sa më konform ligjit, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për pikat e shitjes dhe dhënies me qera të pronësisë artistike nëpër të cilat janë marrë masa me gjobë dhe konfiskim, pas kontrolleve të ushtruara si për produktin artistik vendas ashtu dhe të huaj, por megjithëse janë aplikuar këto sanksione këta subjekte nuk kanë ndryshuar mënyrën e tyre të tregëtimit por vetëm sa e kanë ulur disi masë e piraterisë, këtu nuk duhet të lihen pa u përmendur dhe operatorët që kanë si objekt veprimtarie radio-televizion me të cilët janë bërë kontakte të shpëstë në mënyrë sensibilizimit të tyre pa përdorur direkt sanksionin.

Gjithashtu problem në treg sjellin edhe vetë prodhuesit të cilët nuk e respektojnë ligjin për pajisjen e cdo produkti në treg me pullën e ZSHDA, në mënyrë identifikimit e produktit të rregullt në treg dhe për të mbajtur marrëdhënie sa më të qarta me autorët dhe interpretët e veprave artistike.

Nuk duhet lënë pa u theksuar edhe pjesa e ZSHDA e cila në kuadër të zbatimit të ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të nuk ka pasur mundësinë për mbulimin e gjithë territorit të RSH gjë që ka ndikuar dhe në problemin e krijimit të një database të plotë të subjekteve përdorues/shfrytëzues të pronësisë artistike.

Një tjetër problem është dhe bashkëveprimi institucional, i cili ka një ngarkesë dhe vështirësi për realizim sot për sot pasi cdo institucion fillimisht duhet të realizojë detyrat e veta të cilat i ka primare, dhe më pas të shkojë në ndihmë të institucionit, por pavarësisht nga kjo ZSHDA ka pasur gjoithmonë bashkëpunim shumë të mirë me DPT në bashkëpunim me të cilën aksionet e tyre kanë dhënë shumë rezultat.

Në këtë fazë ku jemi sot është duke u rishikuar ligji për ndryshimin e sanksioneve si edhe për një efikasitet sa më të lartë në zbatimin e tij nga ana e subjekteve përdorues/shfrytëzues së pronësisë artistike.

## ❖ INFORMACION PËR PROCESIN E REGJISTRIM-CERTIFIKIMIT

Në Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit janë depozituar për regjistrim-çertifikim të objektit të veprimtarisë, kontratave kalim të drejtash dhe e drejtë autori, për periudhën kohore Janar 2007-Nëntor 2009, gjithsej **1135** aplikime. Kanë regjistruar dhe çertifikuar objektin e veprimtarisë **154** subjekte që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën botimit, krijimeve kinematografike dhe krijime



të tjera audiovizuale, prodhimit, riprodhimit, shpërndarjes dhe dhe përcjelljes në publik të veprave muzikore, si dhe në fushën e transmetimeve dhe ritransmetimeve radio-televizive.

Janë regjistruar dhe çertifikuar **812** kontrata/deklarata me objekt kalim të drejtash pasurore për veprat muzikore, kinematografike dhe audiovizuale, kontrata të lidhura ndërmjet autorëve/titullarëve të së drejtës dhe subjekteve, persona fizikë apo juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e prodhimit, shpërndarjes, shitjes dhe çdo forme tjetër të përcjelljes në publik të veprave objekt kontrate.

Janë regjistruar dhe çertifikuar **75** vepra sipas kategorive të përcaktuara në nenin 7 të Ligjit Nr. 9380, datë 28.04.2005, "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", ku më të spikaturat janë në fushën letrare, publicistike, krijime shkencore, projekte, kompozime muzikore, krijime dramatike, kinematografike dhe krijime të tjera audiovizuale.

Janë në proces **106** aplikime të depozituara. Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit ka refuzuar regjistrimin dhe çertifikimin për një numër të konsiderueshëm aplikimesh, pasi dokumentacioni nuk ka qenë i plotë, si dhe ka njoftuar subjektet të përmbushin detyrimet e tyre ligjore në zbatim të Ligjit Nr.9380, datë 28.04.2005, "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", duke plotësuar praktikën me dokumentacionin përkatës. Pjesa tjetër e aplikimeve të depozituara janë duke u shqyrtuar nga Sektori i Inspektimit dhe Regjistrim-Çertifikimit.

#### ❖ **GJYKIMI DHE ADMINISTRIMI I ANKIMEVE**

#### ❖ **STRUKTURA ORGANIKE**

Sektori i Gjyimit dhe Administrimit të Ankimeve përbëhet nga:

- Përgjegjësi i Sektorit
- Specialisti

#### ❖ **SFERA E VEPRIMTARISË SË KËTIJ SEKTORI.**

Detyrat, qëllimi dhe objektivat e punës së Sektorit të Gjyimit dhe Administrimit të Ankimeve janë parashikuara në **VKM Nr. 232, datë 19.04.2006 "Për krijimin dhe funksionimin e ZSHDA"** dhe konkretisht në pikat **9, 11, 12, 13, 18, 20, 21, 53, 54, 55, 56** të këtij akti nënligjor dhe konsistojnë në sa më poshtë:

- Shqyrtimi i ankesave me objekt shkeljen e së të drejtës së autorit apo të të drejtave të lidhura me të.

- Shqyrtimi i ankesave lidhur me gjobat e aplikuara nga Inspektorët e ZSHDA-së.
- Ofrimi i shërbimeve të specializuara si ekspertiza dhe konsultimi mbi legjislacionin e së drejtës së autorit, kundrejt tarifave të miratuara me VKM Nr. 343, datë 06.06.2007 “Për miratimin e tarifave për shërbimet që ofron Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit”
- Hartimi i "Shpjegimit Përfundimtar" me shkrim pas përfundimit të procedimit administrativ të zhvilluar për të shqyrtuar kërkesat ankimore me objekt cënimin e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.
- Hartimi i "Vendimit" me shkrim pas përfundimit të shqyrtimit ankesës së subjekteve përdorues ndaj ankimit të gjobës së aplikuar nga Inspektorët e ZSHDA-së.
- Nisja e procedimit administrativ lidhur me kërkesat ankimore të paraqitura, duke e bazuar në nenin 104 të Ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, me synim zgjidhjen me mirëkuptim të konfliktit midis palëve në procedimin përkatës.
- Pjesëmarrja si ekspert i së drejtës së autorit/Person i Tretë pranë organeve gjyqësore dhe dhënia e interpretimit me shkrim mbi çështjen gjyqësore konkrete.
- Përfaqësimi i ZSHDA-së pranë organeve gjyqësore, në rastet kur Zyra thirret në cilësinë e Palës së Paditur në procesin civil dhe dhënia e pretendimeve me shkrim mbi çështjen gjyqësore konkrete.
- Pjesëmarrja në grupet e punës të ngritura për hartimin e draft- akteve ligjore apo nënligjore, në fushën e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.
- Ndjekja e korrespondencës ndër-institucionale lidhur me çështje të së drejtës së autorit.

❖ **KUADRI LIGJOR BAZË PËR REALIZIMIN E DETYRAVE**

Spektori i realizon detyrat funksionale të përfshira në pikën 2 më sipër, duke u bazuar në:

- Kodin e Procedurave Administrative;

- Kodet e Procedurave Civile/Penale;
- Ligjin Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” (LDA);
- VKM Nr. 232, datë 19.04.2006 “Për Krijimin dhe Funksionimin e ZSHDA-së”;
- VKM Nr. 343, datë 06.06.2007 “Për miratimin e tarifave për shërbimet që ofron Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit”;
- Rregulloren e brendshme të ZSHDA-së.

❖ **REALIZIMI I FUNKSIONEVE TË PËRCAKTUARA LIGJËRISHT:**

Duke filluar nga muaji Prill i vitit 2007, pra që në hapat e para të krijimit të ZSHDA-së, angazhimi i këtij sektori në realizimin e detyrave funksionale, ka qënë evident dhe vazhdon të mbetet e tillë për t'i dhënë udhë zgjidhjes së konflikteve administrative dhe gjyqësore për çështje të së drejtës së autorit apo të të drejtave të tjera të lidhura me të.

- **Sektori gjatë vitit 2007:**

Puna e sektorit gjatë vitit 2007 është përmbledhur në tre drejtime kryesore:

**-Shqyrtimi i kërkesave ankimore:**

Numri i ankimeve të paraqitura gjatë periudhës Prill-Dhjetor 2007 rezulton të jetë **29**, prej të cilave **18** kërkesa janë shqyrtuar brenda vitit kalendarik.

Të gjitha këto kërkesa ankimore i janë nënshtruar procedimit administrativ, i cili për **12** prej tyre ka përfunduar me hartimin "Shpjegimit Përfundimtar" të komunikuar palëve të përfshira në këtë procedim.

Në 12 çështjet e përfunduara veçojmë **6** prej tyre, **3** të zgjidhura tërësisht me mirëkuptim midis palëve me ndërmjetësinë e ZSHDA-së, në bazë të nenit 104 të LDA-së, ndërsa për **3** çështjet e tjera rezultojnë zgjedhja e pjesshme me mirëkuptim me njerën nga palët e ankimuara.

Rezutojnë **6 çështje** të pezulluara me kërkesën e palëve për të negociuar e zgjidhur çështjen me mirëkuptim.

Për 11 çështjet e papërfunduara, të paraqitura gjatë dy muajve të fundit të 2007, ka vazhduar procedimi administrativ në vitin pasardhës.

**-Përfaqësimi pranë gjyqësorit:**

Sektori ka përfaqësuar ZSHDA-në në **5 procese gjyqësore** civile (pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë).

Në **4** procese gjyqësore është paraqitur në cilësinë e Personit të Tretë.

Në **1** prej proceseve gjyqësore është thirrur në cilësinë e Palës së Paditur për kundërshtim të aktit administrativ të nxjerrë prej saj "Shpjegim Përfundimtar".

**-Shqyrtimi i ankesave te gjobave:**

Nga ana e Sektorit janë marrë në shqyrtim **2** raste të ankimimit të gjobave të vendosura nga Inspektorët e ZSHDA-së-pjesë e Sektorit të Inspektimit dhe Regjistrim-Çertifikimit si dhe janë nxjerrë aktet administrative "Vendim mbi ankimin e gjobës".

Në një prej rasteve të mësipërm është lënë në fuqi gjoba e aplikuar, pasi është konstatuar e drejtë vendosja e saj ndaj subjektit përdorues për përdorimin pa titull të ligjshëm të produktit intelektual.

- **Sektori gjatë vitit 2008:**

**-Shqyrtimi i kërkesave ankimore:**

Gjatë vitit 2008 (duke u krahasuar me vitin paraardhës), ka patur rritje të numrit të ankimeve të paraqitura nga titullarët e së drejtës së autorit të degëve të ndryshme të artit por edhe nga titullarë të drejtave të tjera të lidhura me të drejtën e autorit si interpretues, shtëpi botuese, shoqëri të prodhimit të fonogrameve/videogramëve etj.

Gjatë vitit 2008, numri i kërkesave ankimore të shqyrtuara si ankime të reja apo si vazhdimësi e shqyrtimit të filluara në fund të vitit 2007, rezulton të jetë **31 çështje**.

Të gjitha këto kërkesa ankimore i janë nënshtruar procedimit administrativ, prej nga rezulton:

Të trajtuara **brenda 2008**, janë gjithsej **28 çështje** nga të cilat:

**Të Përfunduara – 19 çështje** për të cilat:

-Është konkluduar nëpërmjet "Shpjegimit Përfundimtar", për pranimin e ankesës dhe konstatimin i cënimit të së drejtës së autorit ose të interpretuesit/ prodhuesit për **17 çështje**. Nga këto është bërë zgjidhja me mirëkuptim për **5 çështje**, ku mirëkuptimi është arritur tërësisht për 3 çështje, ndërsa në 2 të tjerat, mirëkuptimi është arritur vetëm me njëri nga palët e ankimuara.

-Është bërë rezimi i ankesës për moskonstatim të cenimit të së drejtës së autorit ose moslegjitimim në kërkimin për cënim të së drejtës së prodhuesit- **2 çështje**.

**Të pezulluara - 9 çështje** me kërkesë të palës ankimuese për sigurim provash/palët në procedim janë në proces negociimi për zgjidhje me mirëkuptim/çështja me të njëjtat palë dhe objekt ka nisur më parë në gjykatë.

**-Përfaqësimi pranë gjyqësorit:**

Gjatë vitit 2008, Sektori ka përfaqësuar Zyrën në **17 proçese gjyqësore civile** (pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) në cilësinë e Palës së Tretë/ Palës së Paditur për kundërshtim të Shpjegimit Përfundimtar apo Fletë-Gjobës si dhe në **1 proces gjyqësor penal** pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në cilësinë e dëshmitarit.

**-Shqyrtimi i ankesave te gjobave:**

Nga ana e Sektorit janë marrë në shqyrtim **16 raste të ankimimit të gjobave** të vendosura nga Inspektorët e ZSHDA-së-pjesë e Sektorit të Inspektimit dhe Regjistrim-Çertifikimit si dhe janë nxjerrë aktet administrativë "Vendim mbi ankimin e gjobës".

Mbi të gjitha rastet është vendosur lënia në fuqi e gjobave pasi është gjetur e mbështetur në ligj aplikimi i tyre ndaj subjekteve përdorues pa titull të ligjshëm ose gjoba ka mbetur në fuqi pasi subjekti e ka paraitur tej afatit të caktuar për ankimim ose nuk është bërë shqyrtimi i tyre. Lidhur me këtë të fundit sqarojmë se ankimuesit edhe pasi iu është cituar shprehimisht neni 132 i LDA-së në shkresën-përgjigje të ankesave, kanë refuzuar t'i plotësojnë ankesat përkatëse me kërkesat e përcaktuara, sidomos me konfirmën bankare për pagesën e ½ së vlerës së gjobës së aplikuar.

• **Sektori gjatë vitit 2009:**

**-Shqyrtimi i kërkesave ankimore:**

Viti 2009 shënon numrin më të madh të ankesave të marra në shqyrtim nga Sektori, ku përfshihen ankesat për të cilat ka vazhduar procedimi i nisur në fund të vitit 2008 dhe ato të paraqitura këtë vit.

Kështu i janë nënshtruar procedimit administrativ **149 çështje**, nga të cilat vetëm **132** janë paraqitur nga agjencia "Albautor" gjatë tre-mujorit të parë të këtij viti.

Të total, rezulton:

**Të Përfunduara – 140 çështje** për të cilat është është konkluduar:

-Pranimi i ankesës dhe konstatimi i cenimit të së drejtës së autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me të për **7 çështje** nga të cilat është bërë zgjidhja pjesërisht (vetëm me një nga palët e e ankimuara) me mirëkuptim për **3 prej tyre**.

-Rrëzimi i ankesës për moskonstatim të cenimit të së drejtës së autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me të-**2 çështje**.

-Tërheqja e palës ankimuese nga ankimimi, duke synuar arritjen e marrëveshjes me palët e ankimuara- **131 çështje**

**Të pezulluara - 6 çështje** me kërkesë të palës ankimuese për sigurim provash/palët në procedim janë në proces negociimi për zgjidhje me mirëkuptim/çështja me të njëjtat palë dhe objekt ka nisur më parë në gjykatë.

**Në proces shqyrtimi janë 3 çështje.**

**-Përfaqësimi pranë gjyqësorit:**

Gjatë vitit 2008, Sektori ka përfaqësuar Zyrën në **25 procese gjyqësore** civile të cilat vazhdojnë që nga viti 2007, 2008:

- **20** procese gjyqësore civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) në cilësinë e Palës së Tretë/ Palës së Paditur për kundërshtim të Shpjegimit Përfundimtar apo Fletë-Gjobës.
- **4** procese civile pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
- **1** Rekurs pranë Gjykatës së Lartë.

**-Shqyrtimi i ankesave te gjobave:**

Nga ana e Sektorit janë marrë në shqyrtim **15 (pesëmbëdhjetë)** raste të ankimit të gjobave të vendosura nga Inspektorët e ZSHDA-së-pjesë e Sektorit të Inspektimit dhe Regjistrim-Çertifikimit si dhe janë nxjerrë aktet administrative "Vendim mbi ankimin e gjobës ".

Për **13 (trembëdhjetë) raste** është vendosur lënia në fuqi e gjobave pasi është gjetur e mbështetur në ligj aplikimi i tyre ndaj subjekteve përdorues pa titull të ligjshëm ose gjoba ka mbetur në fuqi pasi subjekti e ka paraitur tej afatit të caktuar për ankimim ose nuk është bërë shqyrtimi i tyre për mungesë të plotësisht të ankesës sipas kërkesave të nenit 132 i LDA-së.

Për **2 (dy)** rastet e tjera është vendosur pranimi i ankesës ndaj gjobës së vendosur, pasi titullarët e së drejtave mbi veprat muzikore të konstatuara të përdorura nga subjektet e gjobuar, sic janë agjencitë e administrimit kolektiv nuk kanë informuar ZSHDA-në mbi pagimin e detyrimeve të përdoruesve për shhfrytëzimin e veprave.

❖ **ANKIMI ADMINISTRATIV DHE PROBLEMATIKA E NDESHUR:**

**Objekti i ankesave:**

Cenim i së drejtës morale dhe pasurore të autoreve apo interpretuesve si rezultat i:

- Prodhimit, riprodhimit pa titull te veprave muzikore
- Botimi i librave pa titull te ligjshem nga shtepite botuese
- Cënim i se drejtes morale te autoreve (moshenimi apo mospermendja e emrit)
- Riprodhim i perkthimit te nje vepre letrare (si veper e prejardhur)
- Shfrytezimi pa titull i veprave audiovizuale, videogrameve

### **Pala ankimuese:**

- Autore (kompozitore, shkrimtare veprash letrare apo studimore, autore tekstesh shkollore, regjisorë, skulptorë, piktore) ose trashëgimtarët ligjorë të tyre.
- Titullmbajtës të së drejtës së autorit si Agjencitë e Administrimit Kolektiv të së drejtës së autorit.
- Prodhuesit e fonogrameve apo videogrameve
- Interpretues (të vepres muzikore).
- Shtëpi botuese.

### **Pala e ankimuar:**

- Shoqëritë e prodhimit të fonogrameve apo videogrameve (CD, DVD, kasetë audio).
- Shkrimtarë, studiues
- Operatorët Radio-Televizive duke përfshirë në këta të fundit edhe ata kabllorë
- Shtëpi botuese
- Shoqëritë e telefonisë celulare
- Entë artistike shtetërore apo institucione të tjera shtetërore.

### **Problematika e ndeshur gjatë shqyrtimit të ankesave:**

- Paraqitja e disa kërkesave ankimore të paplota, pra jo në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin e Procedurave Administrative;
- Mungesa e provave nga pala ankimuese, për të vërtetuar cënimin e së drejtës së autorit/të drejtave të tjera të lidhura me të;
- Pezullimi për një kohë të pacaktuar i procedimeve administrative, me kërkesë të palës ankimuese, deri në sigurimin e provave materiale e shkresore;

- Mosparaqitja e palës së ankimuar në seancë dëgjimore, e cila sjell veshtirësi në procedim, pasi nuk perballen deklaratimet e palëve në konflikt;
- Mosparaqitja në seancë e Palës së Tretë, e cila ka dijeni për çështjen (përmendim këtu mungesën e disponimit të informacioneve të kërkuara apo mosparaqitjen në seancë të përfaqësuesve të KKRT-së);
- Mosparaqitja në seancë apo mungesa e informacionit me shkrim (nëse prezenca fizike është e pamundur objektivisht) e institucioneve shtetërore kur ato janë në pozicionin e palës së ankimuar.

**❖ Shembuj/raste të ankimimeve për cënim të së drejtës së autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me të Viti 2007**

Objekti i ankimimit	Pala ankimuese	Pala e ankimuar	Stadi i proçedit administrativ
1)Pushimi i cënimit të të drejtës së autorit dhe shpërblim për përdorim pa titull të pronësisë artistike – muzikë e huaj (prodhim CD-je).	“Albautor”- në cilësinë e përfaqësueses të titullarëve të së drejtës së autorit për vijën muzikore të veprave muzikore të perdorura pa autorizim për prodhimin e CD-ve.	Gazeta“ .....”, Gazeta“ .....”, Gazeta“ .....”, Gazeta“ .....”, Në cilësinë e prodhuesve të CD me muzikë të huaj, pa autorizimin e titullarit të së drejtës së autorit.	Përfunduar (në 2007) dhe konkluduar nga ZSHDA me Shpjegimin Përfundimtar: 1.Konstatimi i cënimit të së drejtës morale dhe ekonomike të autorëve nga palët e ankimuara sipas neneve 5, 10, 13,112, 114 të LDA-së. 2.Detyrimi i palëve të ankimuara të pushojnë cënimin dhe dëmshpërblejnë autorët sipas nenit 34/2 të LDA-së.



<p>Pushim i cënimit të së drejtës së autorit dhe shpërblim për përdorim të veprës letrare.</p>	<p>Z. .... Z. .... Në cilësinë e bashkëautorëve të veprës “.....”.</p>	<p>Shtëpia botuese dhe shtypshkronja ”.....”, në cilësinë e botueses pa autorizimin e autorëve të veprës letrare “.....”</p>	<p>Përfunduar (në 2007) dhe konkluduar nga ZSHDA me Shpjegimin Përfundimtar: 1.Konstatimi i cënimit të së ë morale dhe ekonomike së bashkëautorëve nga pala e ankimuar sipas neneve 5, 6, 10, 13, 38, 40 të LDA-së. 2.Detyrimi i palës së ankimuar të pushojë cënimin e së drejtës dhe të dëmshpërblejë autorin sipas nenit 34/2 të LDA-së.</p>
--	--	--	---

❖ **Shembuj të ankimimeve për cënim të së drejtës së autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me të Viti 2008**

Objekti i ankimimit	Pala ankimuese	Pala e ankimuar	Stadi i procedimit administrativ
<p>Ndërhyrje e ZSHDA-së për të saktësuar dhe rregulluar veprimtarinë e palës cënuese sipas LDA-së.</p>	<p>Z..... në cilësinë e autorit të videogramit “.....”</p>	<p>TV “.....” në cilësinë e transmetuesit pa autorizimin e autorit të sekuecave të videogramit “.....”</p>	<p>Përfunduar (në 2008) dhe konkluduar nga ZSHDA me Shpjegimin Përfundimtar: -Konstatimi i cënimit të së drejtës morale dhe ekonomike së autorit nga pala e ankimuar sipas neneve 5,10, 13 te LDA-së. 2.Detyrimi i palës së ankimuar të pushojë cënimin e së drejtës dhe të dëmshpërblejë autorin sipas nenit 34/2 të LDA-së.</p>
<p>Pushim i cënimi të së drejtës së autorit, interpretit dhe bashkëprodhuesve të veprës muzikore</p>	<p>-Z..... – në cilësinë e autorit (kompozitorit) të veprës muzikore “.....” dhe bashkëprodhuesit të saj. -Z. ....- në cilësinë e interpretit të veprës muzikore “.....” dhe</p>	<p>Shoqëria e telefonisë celulare “.....”-në cilësinë e përdoruesit pa autorizimin e titullarëve të së drejtës së autorit/interpretit/prodhuesit të veprës</p>	<p>Përfunduar (në 2008) dhe konkluduar nga ZSHDA me Shpjegimin Përfundimtar: 1.Konstatimi i cënimit të së drejtës së autorit të veprës muzikore nga pala e ankimuar sipas neneve</p>

	bashkëprodhuesit te saj.	muzikore “.....” në formën e ringtonit.	5,10, 13 të LDA-së. 2.Konstatimi i cënimit të së drejtës së interpretit të veprës muzikore nga pala e ankimuar sipas neneve 53 dhe 55 të LDA-së. 3.Konstatimi i cënimit të së drejtës së prodhuesve të veprës muzikore nga pala e ankimuar sipas nenit 59 të LDA-së. 4.Detyrimi i palës së ankimuar të pushojë cënimin e së drejtës dhe të dëmshpërblejë autorin sipas nenit 34/2 të LDA-së.
--	--------------------------	---	---

**❖ Shembuj të ankimimeve për cënim të së drejtës së autorit ose të drejtave të tjera të lidhura me të Viti 2009**

Objekti i ankimimit	Pala ankimuese	Pala e ankimuar	Stadi i proçedimit administrativ
Lidhja e kontratave autorizuese për riprodhimin e veprës kinematografike dhe pagimi i shpërblimit të së drejtës së autorit për përdorimin pa titull.	Agjencia “FMAA”- në cilësinë e përfaqësuesit të licencuar të titullarëve të së drejtës së autorit (regjisorë, skenaristë) të veprave kinematografike dhe audiovizuale shqiptare.	Shoqëria “.....”- në cilësinë e riprodhuesit të veprave kinematografike shqiptare në CD dhe DVD.	Përfunduar (ne 2009): -Tërhequr ankesa nga pala ankimuese pasi çështja është zgjidhur me mirëkuptim me ndërmjetësinë e ZSHDA-së, gjatë kohës së proçedimit administrativ.
Shlyerja e detyrimeve ndaj Titullarëve të së drejtës së prodhimit dhe transmetimit të veprave audiovizuale-programe	Shoqëria “.....”- në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar te TV-ve të huaj -titullarë të së drejtës së prodhimit të veprave audiovizuale ose të së drejtës se transmetimit të tyre.	Televizionet Kabllore.....- në cilësinë e transmetuesit/ ritransmetuesit të veprave audiovizuale, pa shpërblyer titullarët e tyre per përdorimin ekonomik të tyre.	Përfunduar në 2009, konkluduar nëpërmjet Shpjegimit Përfundimtar: 1)Konstatim cënimit nga të gjitha palët e ankimuarra të së

televizive të huaja.			drejtës ekonomike të titullarëve të së drejtës së prodhimit dhe transmetimit të veprave audiovizuale. 2)Zgjidhje me mirëkuptim e konfliktit me disa nga palët e ankimuara, me ndërmjetësinë e ZSHDA-së, gjatë kohës së procedimit administrativ. 3) Detyrimi i palëve të tjera të ankimuara të pushojnë çënimin e të drejtave të titullarëve dhe t'i dëmshpërblejnë ata sipas kontratave të lidhura midis tyre.
----------------------	--	--	---

❖ **PROCESET GJYQËSORE KU ËSHTË PËRFSHIRË ZSHDA**

**Nisur në 2007**

<b>Pala Paditëse</b>	<b>Pala e paditur</b>	<b>Pozicioni ZSHDA</b>	<b>Objekti i padisë</b>	<b>Shkalla e Gjyqësorit</b>	<b>Stadi i gjykimit</b>
TV..... pretenduar si titullare së së drejtës së	-Agjencia e Administrimit kolektiv “.....”	Person i Tretë	Shpërblim dëmi për e kontraktual përdorimin veprës audiovizuale.	Shkalla I, Tiranë.  (vendosur rrëzim padie duke marrë parasysh edhe interpretimin e	Në proces,  Shkalla II.

transmetimit.	-TV kabllor “.....”			ZSHDA-së)	
Z.....  Z.....  Bashkëautore të veprës letrare	Shtëpia botuese  “.....”	Person  i Tretë	Shpërblimi i dëmit si rezultat i cënimit të së drejtës morale dhe ekonomike të autorit të veprës letrare	Shkalla I, Tiranë.  (vendosur pranimit padie duke marrë parasysh edhe interpretimin e ZSHDA-së)	Në proces,  Shkalla II.

❖ **PROCESET GJYQËSORE KU ËSHTË PËRSHIRË ZSHDA**

**Nisur në 2008**

<b>Pala Paditëse</b>	<b>Pala e paditur</b>	<b>Pozicioni ZSHDA</b>	<b>Objekti i padisë</b>	<b>Shkalla e Gjyqësorit</b>	<b>Stadi i gjykimit</b>
Shoqëria “.....”- Përfituese e palicencuar e shpërblimit për përdorimin e produktit artistik.	ZSHDA	Palë e Paditur	Kundërshtim i vendimit të ZSHDA-së lidhur me ankesën e gjobës së Inspektorëve të ZSHDA-së.	Shkalla I, Tiranë:  Vendosur rrezim padie dhe nxjerrje jashtë juridiksionit, për mosezaurim të rrugës administrative të ankimit.	Nuk është apeluar.
Shoqëria “.....”- përfaqësuese e	TV kabllor..... ..	Dëshmitar	Ndjekje penale sipas neneve 148, 149 te Kodit Pen	Shkalla I, Fier  Vendosur:	-

autorizuar e titullarëve të së drejtës mbi veprat audiovizuale të huaja.			dhe shpërblim demi.	Pushimi i gjykimit, për heqjen dorë nga padia.	
--	--	--	---------------------	--	--

❖ **PROCESET GJYQËSORE KU ËSHTË PËRFSHIRË ZSHDA**

**Gjatë vitit 2009**

<b>Pala Paditëse</b>	<b>Pala e paditur</b>	<b>Pozicioni ZSHDA</b>	<b>Objekti i padisë</b>	<b>Shkalla e Gjyqësorit</b>	<b>Stadi i gjykimit</b>
Z.....- Autor teksti mësimor	Institucion arsimor....	Person i Tretë	Shpërblimi i dëmit si rezultat i cënimit të së drejtës morale dhe ekonomike të autorit.	Shkalla I, Tiranë	Në proces
Z. ....- interpret	-Subjekti .....  -ZSHDA	E paditur	Kundërshtim i Shpjegimit Përfundimtar të ZSHDA-së lidhur me ankesën e palës paditëse pranë ZSHDA-së kundër palës së paditur.	Shkalla I, Tiranë	Në proces

## **□ Monitorimi dhe Licensimi i Agjencive të Administrimit Kolektiv**

### **❖ Struktura dhe kompetencat e Sektorit të Licensimit dhe Monitorimit të Agjencive të Administrimit Kolektiv**

Sektori i Liçensimit dhe Monitorimit të Agjencive të Administrimit Kolektiv ka në organikën e vet sipas parashikimeve të VKM nr. 232 datë 19.04.2006 “Për krijimin dhe funksionimin e ZSHDA-së” një specialist në varësi të drejtpërdrejtë të Titullarit të institucionit.

Detyrat, qëllimi dhe objektivat e punës së Sektorit të Liçensave dhe Monitorimit të Agjencive të administrimit kolektiv janë të përcaktuara në përgjithësi në VKM nr. 232 datë 19.04.2006 dhe më të shtjelluara në Rregulloren e Brendshme të institucionit. Disa prej tyre sipas rëndësisë që mbartin evidentohen më poshtë:

- Shqyrtimin e kërkesave të të interesuarve për t’u liçensuar si agjensi të administrimit kolektiv në fushën e menaxhimit të së drejtës së autorit si dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, bazuar në formularin standard të plotësuar nga ana e tyre. Pasi kontrollon dokumentacionin e paraqitur, bën verifikimet e nevojshme, dëgjon palën e interesuar në seancën dëgjimore si dhe konkludon se kërkesat plotësohen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve së bashku me Sektorin e Rregjistrim – Çertifikim & Inspektimit, përgatit propozimin për liçencim të agjencive të administrimit kolektiv.
- Hartimin e relacioneve të qarta duke dhënë mendime nëse kërkuesi nuk plotëson kushtet për t’u liçensuar në fushën e administrimit kolektiv të së drejtës së autorit, pasi ka ndjekur hapat e përshkruara më sipër. Këtë informacion ia paraqet drejtuesit të institucionit dhe palës së interesuar në një afat kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh.
- Analizimin e informacionit në mënyrë sistematike.
- Përcaktimin e kontratave/marrëveshjeve/etj, për kalimin e të drejtave nga këto agjenci të përdoruesit e pronësisë artistike dhe bashkëpunon me Sektorin e Rregjistrim –Çertifikimit &Inspektimit për regjistrat përkatës për kalimin e të drejtave.

Asocimin me punën e grupit, sipas kërkesave të sektorëve të tjerë.

### **❖ Agjencitë e administrimit kolektiv të të drejtave të autorëve dhe të drejtave të tjera të lidhura me të**

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9380 datë 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij mund të themi se Shqipëria ka një kuadër ligjor të plotë dhe të përafërt me atë të vendeve europiane në fushën e pronësisë intelektuale artistike, letrare, shkencore.

Një kapitull i rëndësishëm në përmbajtje të këtij ligji, por dhe për vetë mënyrën e konceptimit të funksionimit të kësaj fushe, e zënë agjencitë e administrimit kolektiv. Në nenet 106 – 116 sanksionohen dispozitat e mënyrës së krijimit, funksionimit, atributiveve, detyrimeve, përgjegjësi si dhe çdo aspekt tjetër juridik i nevojshëm për agjencitë e administrimit kolektiv të të drejtave të autorëve apo të drejtave të lidhura me të drejtat e autorëve. Ligjvënësi, bazuar në doktrinën europiane dhe atë mbarë botërore, por duke treguar vëmendje të veçantë edhe karakteristikave

specifike tregut ballkanik dhe atij shqiptar në veçanti, ka përpiluar një kuadër ligjor për sa i përket krijimit, liçensimit, funksionimit, kontrollit dhe masave administrative që mund të merren ndaj këtyre subjekteve.

Është parashikuar qartazi se agjencitë e administrimit kolektiv krijohen sipas degëve të artit dhe jo më shumë se një agjenci për një degë të caktuar. Është mbajtur parasysh në këtë pikë të nenit 108 nevoja për forcimin e agjencive dhe për ruajtjen dhe forcimin e vlerave.

Agjencitë e administrimit kolektiv janë persona juridikë që i përkasin të drejtës private, të krijuara nga bashkimi me vullnet të lirë të titullarëve të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të dhe ka për objekt kryesor të aktivitetit, mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave, administrimi i të cilave u është besuar nga titullarët. Agjencitë e administrimit kolektiv krijohen dhe funksionojnë sipas ligjit Nr **8788** datë 07.05.2001 për OJF-të dhe ligjit nr. 9380 datë 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

Këto agjenci krijohen nga titullarët e të drejtave dhe administrojnë të drejtat e një kategorie të caktuar, anëtarësh apo subjekteve të të drejtave të lidhura, aktiviteti i tyre kontrollohet nga ZSHDA, në përputhje me dispozitat e LDA.

Agjencitë e Administrimit Kolektiv janë të detyruara të përcaktojnë dhe të monitorojnë tarifatat për fushën e tyre të aktivitetit, të cilat duhen negociuar me përdoruesit për sa i përket pagesës së këtyre të drejtave.

Gjithashtu, agjencitë në fjalë duhet të autorizojnë përdoruesit, kundrejt një pagese, me një license – autorizim të shkruar si dhe të nënshkruajnë në emër të titullarëve të të drejtave, kontrate të përgjithshme me përdoruesit të cilat kanë për objekt autorizimin e përdorimit të repertorit të mbrojtur nga agjencitë.

Një rol i qënësishëm i agjencive të administrimit kolektiv është edhe mbrojtja e interesit të anëtarëve të vet jashtë territorit të RSH-së, nëpërmjet kontratave të përfaqësimit reciprok me agjencitë simotra në botë.

Mbledhja e shumave që detyrohen përdoruesit dhe shpërndarja e tyre ndërmjet titullarëve të të drejtave, në përputhje me detyrimet e ligjit dhe parashikimet statutoare, është në kompetencë të këtyre agjencive.

Po këto agjenci, duhet të kërkojnë nga përdoruesit apo përfaqësuesve të tyre komunikimin e informacionit si dhe vendosjen në dispozicion të dokumentave të nevojshme për të përcaktuar sa më korrekt, pagesën që këta përdorues duhet të bëjnë, si dhe informacion në lidhje me veprat e përdorura, titullari i të drejtës për të ndihmuar në një shpërndarje sa më të drejtë.

Agjencitë e administrimit kolektiv mbartin detyrimin ligjor të sigurojnë aksesin e nevojshëm anëtarëve të vet për çfarëdo lloj informacioni që ka të bëjë me administrimin e agjencisë, t’u vendosë në dispozicion asistencë të specializuar juridike si dhe t’i përfaqësojë në çështje ligjore, të

sigurojë transparencën e aktivitetit të administrimit kolektiv në raport me autoritetet shtetërore të cilat kanë të drejtë kontrolli, të përmbushin çdo lloj tjetër aktiviteti në kuadrin e një mandati të posaçëm të dhënë nga titullari i së drejtës së autorit apo të drejtës fqinje, brenda limitit të aktivitetit për të cilin është krijuar.

Në Shqipëri ushtrojnë aktivitetin një numër prej 4 agjenci të liçencuara të administrimit kolektiv, detyrimi i të cilave është administrimi i kategorive të ndryshme të të drejtave, mbledhja dhe shpërndarja e të ardhurave që vijnë si rezultat i administrimit të të drejtave të besuara nga titullarët përkatës.

Në kuadrin e të drejtave të autorit funksionojnë ALBAUTOR i cili administron të drejtat e autorëve të muzikës dhe regjistrimeve mekanike dhe FMAA, e cila administron të drejtat e autorëve të regjisorëve e skenaristëve të veprave kinematografike dhe veprave të tjera të audiovizualit.

Në kuadër të kategorisë së të drejtave të lidhura me të drejtat e autorit, ushtrojnë aktivitetin dy agjenci të tjera të administrimit kolektiv, konkretisht AKDIE e cila administron të drejtat e artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues dhe AMI e cila administron të drejtat e prodhuesve të fono/videogramit.

**ALBAUTOR** Agjenci e Administrimit Kolektiv për Muziken dhe të gjitha të drejtat e regjistrimeve mekanike të pronësisë artistike.

LIÇENCË Nr. 1 datë 05.07.2007, Urdhër Nr.448, datë 05.07.2007

Fletore Zyrtare nr.89 korrik 2007

**FMAA** Agjencia e Administrimit Kolektiv për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera të audiovizualit .

LIÇENCË : Nr.2 datë 01.04.2008, Urdhër Nr.301, datë 01.04.2008

Fletore Zyrtare nr.50 datë 11.04 2008

**AKDIE** Agjencia e Administrimit Kolektiv për të drejtën e artistëve interpretë dhe/ose ekzekutues të veprave me të gjitha format e përcjelljes së interpretim/ekzekutimit të tyre në publik .

LIÇENCË : Nr.3 /Dt. 09/07/2008, Urdhër Nr.669, datë 22.05.2008

Fletore Zyrtare nr.119 datë 30.07. 2008



**AMI** Agjenci e Administrimit Kolektiv në Fushën e Prodhuesve të muzikës dhe audiovizualit (Fonogramë dhe videogramë) Shqiptare

LIÇENCË Nr. 4 datë 05.07.2007, Urdhër Nr.92, datë 26.03.2009

Fletore Zyrtare nr.33 datë 26.03.2009

❖ **Çështje me interes për sa i përket agjencive të administrimit kolektiv**

- Nga analiza e hollësishme dokumentare, por dhe nga pikëpamja formale e funksionimit në treg të agjencive të administrimit kolektiv në Shqipëri, ky vit që është drejt përfundimit, ka qenë i mbushur me evenimente të cilat të paktën në dukje kanë treguar një rritje të përgjegjshmërisë dhe ndjeshmërisë së administrimit të produktit intelektual artistik kryesisht. Në këtë prizëm, vlen të përmendet krijimi dhe liçensimi nga autoriteti kompetent, i agjencisë së prodhuesve të fonogramit, A.M.I, e cila ishte edhe promotor i një bashkimi dhe koordinimi të ideve dhe mjeteve të tre prej agjencive (Albautor – AKDIE - AMI) në qëllim të një mirë- funksionimi të prezencës në tregun e shfrytëzimit të produktit intelektual duke tentuar në këtë mënyrë një administrim më efikas dhe afatgjatë të pronësisë intelektuale, e cila e përkthyer në terma financiarë do të thotë më shumë lekë të grumbulluara dhe proporcionalisht më shumë lekë të shpërndara tek përfituesit e drejtëpërdrejtë autorë – artistë interpretues dhe/ose ekzekutues – prodhues. Kjo risi në tregun shqiptar është për t`u përshëndetur me rezervën e testimit të jetëgjatësisë si dhe më e rëndësishmja testimi i seriozitetit dhe efikasitetit me të cilën këto agjenci do të raportojnë vitin kalendarik të ardhshëm para ZSHDA-së, sipas afateve ligjore.
- Është negociuar me agjencitë e administrimit kolektiv për njehsimin e tarifave. Ky negociim sollti një sistem tarifor të unifikuar si rezultat i bashkimit të tre agjencive dhe kryerjen e pagesave në një sportel të vetëm.
- Zyra ka qënë në rolin e negociatorit në bisedimet e zhvilluara midis Shoqatës së Hotelierëve të Shqipërisë dhe bashkimit të tre agjencive të administrimit kolektiv (Albautor, AKDIE, AMI) për të vendosur me marrëveshje mbi tarifën që subjektet (përdorues të pronësisë intelektuale) - hotelet/njësitë akomoduese duhet të paguajnë kundrejt agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit për produktin intelektual që përdorin në ambientet e tyre (holle/bar/restorant)
- Janë në negociim e sipër agjencitë dhe televizionet për vjeljen e detyrimeve për përdorim të produktit artistik.
- Po punohet për përgatitjen e një fushate të rëndësishme informimi të subjekteve, të cilat do të njihen më mirë me fokusin e ligjit, praktikën e agjencive të administrimit kolektiv etj.
- Sektori i Monitorimit ka shtuar presionet për verifikimin e bilanceve të agjencive në detaje dhe për hir të së vërtetës janë vënë re një sërë parregullsish duke filluar me zbardhjen e të gjithë zërave të bilancit dhe pasqyrimin e tyre.

- Procesi i shpërblimit të autorëve nga ana e agjencive është ende i vështirë për t'u arritur plotësisht, pasi agjencitë nuk janë transparente në deklarimin e të ardhurave duke "u justifikuar se mungojnë të ardhurat e mjaftueshme për të dhënë këto shpërblime"
- Vazhdon ende të jetë e përfshirë në kuadrin e problematikës që paraqesin tri agjencitë e administrimit kolektiv "FMAA" "AKDIE" dhe "AMI", mungesa e kontakteve dhe e marrëveshjeve të bashkëpunimit reciprok midis secilës prej tyre dhe organizatave ndërkombëtare simotra, pra agjencive të administrimit kolektiv që mbrojnë të drejtat e autorit/të drejta të lidhura me të sipas degës së artit për të cilat janë licencuar.

### ❖ **Problematika e konstatuar**

- **Problemet e mjedisit ku operojnë agjencitë:**

Tregu shqiptar i pronësisë intelektuale paraqitet problematik për vet specifikën që mbart, si edhe për periudhën e shkurtër në të cilën është ndërtuar.

Disa nga problemet e vëna re gjatë periudhave të monitorimit janë si më poshtë:

- Nuk zbatohen rregullat bazë teknike të riprodhimit të krijmtarisë. Kjo ndodh nga subjekte që operojnë në mënyrë pirate dhe që s`janë të licencuar .
- Ekziston një veprimtari tregtimi pirate në masë pa patur mundësi identifikimi pasi kryhen në ambiente të fshehta që u shpëtojnë autoriteteve tatimore (në bodrume, përmes internetit , etj)
- Ka vështirësi nga subjektet për të njohur ligjin dhe masat ndëshkuese që vijnë prej tij në raste mos respektimi nga këto subjekte të ligjit.

- **Problemet që konstaton ZSHDA kundrejt tregut dhe agjencive**

ZSHDA gjatë inspektimeve në terren has një sërë problemesh si më poshtë:

- Mos kryerja e fushatave informuese nga ana e agjencive kundrejt subjekteve bëjnë që këto të fundit, të mos kenë informacionin e nevojshëm, për të pranuar zbatimin e kompetencave të agjencive. Kjo gjë, bën që ZSHDA, të ndërhyjë me kërkesë të agjencive duke u gjendur brenda konflikteve që mund të evitoheshin me një organizim më të mirë të agjencive.
- ZSHDA has vështirësi në marrjen e informacionit financiar dhe informacioneve të tjera lidhur me të, me qëllim zbardhjen e plotë të veprimtarisë së këtyre agjencive.
- Bilancet, që këto agjenci dorëzojnë pranë ZSHDA-së cdo vit (mars), paraqiten me mangësi të shumta në pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat nuk korrespondojnë me njëra-tjetrën. Megjithë insistimet e Zyrës dhe ndërhyrjet e saj për të

marrë një ekspert kontabël për rishikimin e këtyre bilanceve, përsëri këto paraqesin mangësi të shumta.

## □ **Marrëdhëniet me Jashtë, Publikun dhe Shërbimet Mbështetëse të ZSHDA-së**

- Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjës për koordinimin, organizimin dhe mbarëvajtjen e marrëdhënieve të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit me organizmat ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, apo me struktura homologe ose që lidhen me fushën e veprimtarisë së të Drejtës së Autorit e të Drejtave të tjera të lidhura me të në Evropë dhe në mbarë botën. Sektori duhet të punojë për vendosjen e kontakteve të reja bashkëpunuese me struktura ndërkombëtare. Sektori duhet të koordinojë punën e ZSHDA-së me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe me Ministrinë e Integritimit, sa i takon detyrimeve konkrete që Qeveria Shqiptare duhet të përmbushë në procesin e integritimit të Shqipërisë, të përcaktuara në MSA. Sektori gjithashtu do të mbulojë komunikimin me publikun, duke përfshirë këtu: seminare dhe shfaqje publike të ZSHDA-së me synim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit vendas, ashtu edhe marrëdhëniet transparente dhe informuese me median.

Pikat kryesore të aktivitetit të këtij sektori janë:

### ❖ **Bashkëpunimi me Organizmat Ndërkombëtare:**

Zyra Shqiptare e të Drejtave të Autorit, **qëndron në kontakte të ngushta me struktura ndërkombëtare**, siç janë Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (OBPI). ZSHDA mban marrëdhënie shumë të ngushta bashkëpunuese dhe me **Komisionin Europian** në Tiranë dhe me instrumentat e tij të asistencës teknike sic është TAIEX. ZSHDA është në kontakte dhe me struktura homologe që gjenden në vende të ndryshme të Evropës, për të koordinuar punën me to dhe për të ndarë eksperiencat më të mira

### ❖ **Integrimi europian/ Detyrime nga MSA:**

Pronësia Intelektuale - e drejta e autorit, është një ndër angazhimet kryesore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që rrjedhin nga **Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit** (Neni 73- Pronësia Intelektuale), angazhim ky, për të cilin është përgjegjës Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit,

### ❖ **Marrëdhëniet me publikun dhe mediat:**

Një ndër qëllimet kryesore të ZSHDA, është institucionalizmi dhe ngritja në një nivel të kënaqshëm i prezantimit të aktivitetit të saj në publik. Kjo Zyrë ka detyrim të saj, jo vetëm të realizojë transparencën ndaj publikut, por kryesisht të kryejë një proces sensibilizues, i cili të synojë rritjen e nivelit të njohurive dhe të përgjegjshmërisë jo vetëm tek strukturat shtetërore, të cilat do të lidhen në zinxhir bashkëpunimi me ZSHDA, por dhe ndaj operatorëve ekonomikë, mbajtësve dhe përdoruesve të pronësisë intelektuale (të drejtës së autorit).

## ❖ (prill 2007-dhjetor 2009)

### ✓ **Bashkëpunimi me zyrat homologe jashtë vendit:**

Që në momentet e para të krijimit të institucionit, për vetë natyrën specifike të vetë fushës e Drejta e Autorit (autori vendas dhe ai i huaj), ZSHDA ka patur në fokus të punës së saj, vendosjen e marrëdhënieve bashkëpunuese të ngushta me struktura ndërkombëtare, që veprojnë në fushën e Pronësisë Intelektuale. Përvec bashkëpunimit me strukturat e Komisionit European të cilët janë dhe të themi kontrollueset kryesore të aktivitetit dhe performancës së qeverisë shqiptare dhe të ZSHDA-së respektivisht, ZSHDA ka marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (OBPI).

OBPI ka qënë një ndër mbështetësit dhe financuesit kryesorë të disa aktiviteteve të zhvillura për të drejtën e autorit në Shqipëri. Që nga krijimi i ZSHDA-së e deri më sot numërojmë disa seminare të zhvilluara në Tiranë, të cilat synonin jo vetëm trajnimin e stafit të ZSHDA-së dhe të institucioneve të tjera shtetërore të përfshira në procesin e zbatimit të ligjit, por edhe sensibilizmin dhe ndërgjegjësimin e kategorive të tjera. Pjesë e këtyre seminareve kanë qënë gjithmonë edhe përfaqësues të komuniteteve të ndryshme të përdoruesve më të mëdhenj, operatorët radio-televizive, operatorët e telefonisë celulare, TV kabllorë, hotelierë e botues etj.

Gjithashtu, financiar po nga OBPI dhe nga KE, ZSHDA ka vendosur marrëdhënie të mira bashkëpunimi me Këshillin Britanik të të Drejtës së Autorit, me Zyrën Rumune të të Drejtave të Autorit, Zyrën Kroate të Pronësisë Intelektuale, Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Malit të Zi etj. Këto bashkëpunime deri më sot kanë shërbyer më së shumti për trajnimin dhe rritjen profesionale të sfatit të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, por edhe të vendosjes së bashkëpunimit me qëllim shkëmbimin e vazhdueshëm dhe në kohë të informacioneve me interes për vendet e rajonit.

## ❖ **ORGANIZATA BOTËRORE E PRONËSISË INTELEKTUALE (OBPI)**

**ZSHDA** ka patur vëmendjen dhe mbështetjen e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale që në momentin e krijimit të saj deri më sot, (OBPI).

*“OBPI është krijuar nga Konventa e OBPI e vitit 1967 me mandat nga Shtetet Anëtare për të promovuar mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale në mbarë botën përmes bashkëpunimit midis shteteve dhe në bashkëpunim dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare. Zyrat e saj ndodhen në Gjenevë, Zvicër”.*

**Vizioni i OBPI është “Pronësia intelektuale është një mjet i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të të gjitha shteteve”. Misioni i saj është promovimi i përdorimit efektiv dhe mbrojtja e pronësisë intelektuale në mbarë botën.**

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (OBPI) është organizatë ndërkombëtare dedikuar promovimit të krijimtarisë dhe risive, duke siguruar që të drejtat e krijuesve dhe të mbajtësve të të drejtave të pronësisë intelektuale, janë të mbrojtura në mbarë botën dhe që shpikësit dhe autorët janë të njohur dhe të shpërblyer për zotësinë e tyre.

Si një agjensi e specializuar e Shteteve të Bashkuara, OBPI ekziston si një forum për shtetet e tij anëtare, për të krijuar dhe harmonizuar **rregullat dhe praktikat** për të mbrojtur të Drejtat e Pronësisë Intelektuale. Shumë shtete të industrializuara kanë sisteme mbrojtje që janë me shekuj të vjetra. Shumë vende të reja dhe në zhvillim janë duke krijuar sistemet e tyre dhe ligjet e markave, patentave dhe të të drejtës së autorit.

Me globalizimin e shpejtë të tregtisë, në këtë dekadë të fundit, OBPI luan një rol kyç në mbështetjen e këtyre sistemeve të reja për t'u zhvilluar nëpërmjet negociimit, asistencës teknike dhe ligjore, trajnimeve në forma të ndryshme, duke përfshirë dhe fushën e zbatimit të të drejtave të Pronësisë Intelektuale.

Fusha e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura është përhapur në mënyrë dramatike ashtu si zhvillimet teknologjike kanë sjellë mënyra të reja të shpërndarjes së krijimeve në mbarë botën, përmes formave të komunikimit si transmetimet satelitore, disqet (CD), DVD dhe Interneti. OBPI është shumë e përfshirë në debatin ndërkombëtar, që po zhvillohet për të formëzuar standarte të reja për mbrojtjen e të drejtës së autorit në cyberspace.

**OBPI** administron traktatet ndërkombëtare të mëposhtme **mbi të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të:**

- Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike;
- Konventa e Brukselit lidhur me shpërndarjen e programit – që transmetojnë sinjale nëpërmjet satelitit;
- Konventa e Gjenevës për mbrojtjen e prodhuesve të fonogramit kundrejt dublikimeve të paautorizuara të fonogrameve të tyre;
- Konventa e Romës për mbrojtjen e performuesve, prodhuesve të fonogramit dhe organizatave transmetuese;
- Traktati i OBPI për të Drejtat e Autorit (WCT);
- Traktati i OBPI për Interpretuesit dhe Fonogramet (WPPT)

OBPI gjithashtu ka një **Qendër Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi**, e cila ofron shërbime për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare tregtare midis palëve private duke përfshirë pronësinë intelektuale.

Çështja e subjektit të këtyre seancave i përfshin të dyja debatet kontraktuale ( të tilla si licencat e patentave dhe programeve kompjuterike, marrëveshjet bashkë-ekzistuese të markave, dhe marrëveshjet e kërkimit dhe të zhvillimit) dhe mosmarrëveshjen jo-kontraktuale (të tilla si shkeljet e

patentave). Qendra është gjithashtu e njohur si një sigurues shërbimesh, drejtues në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që linden regjistrimi abuziv dhe përdorimi i emrave të internet domain.

### ❖ **MBËSHËTETJE E OBPI PËR ZSHDA** (Seminare dhe trajnime )

- **Tetor 2007- Tetor 2008:**

2 vizita studimore në Londër trajnim/kurs *dy-javor* “*Mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të*” për 3 punonjës të zyrës, trajnim, i cili bëhet çdo vit nga Këshilli Britanik i të Drejtës së Autorit në bashkëpunim me Akademinë e OBPI, i cili trajnon specialistë të zyrave të të drejtës së autorit mbi konceptet bazë të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të si edhe mbi eksperiencën të shumta dhe specifike sidomos në kushtet e ndryshimeve të fuqishme teknologjike, që ndodhin çdo ditë në mjedisin digjital. Profesorët dhe lektorët e këtij trajnimi janë personalitete me emër në këtë fushë të tillë si : Adriano Sterling etj. Ndjekja e këtij kursi është shumë frutdhënëse dhe me vlerë për nivelin e specialistëve që e frekuentojnë këtë trajnim 2-javor.

- **28-29 maj 2008, Tiranë**

#### ”Seminar Kombëtar për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me të”,

Në këtë seminar ishin të ftuar dhe ndanë eksperiencën e tyre personalitete të shquara në fushën ndërkombëtare të së drejtës së autorit, si: **Z. Mihaly Fiscor**, Kryetar i Aleancës për të Drejtat e Autorit për Europën Qendrore dhe Lindore dhe një ndër personalitetet më të shquara të të drejtës së autorit në WIPO (CEECA), **Z. Manisekaran Amasi**, Këshilltar, në Divizionin e të Drejtës së Autorit, (WIPO), **Z. Victor Nabhan**, Profesor në Universitetin e Notingamit, Kryetar i Shoqërisë Ndërkombëtare të Veprave Letrare dhe Artistike, (ALAI - Francë), me përfaqësuesit e institucioneve shqiptare të përfshira në procesin e respektimit të së drejtës së autorit dhe grupeve të ndryshme të interesit në qarkullimin e produktit intelektual në Shqipëri.

Pjesëmarrës në këtë seminar kombëtar 2-ditor, ishin përfaqësuesit e institucione të ndryshme të administratës shtetërore, të cilët përbëjnë hallkat kryesore të zinxhirit institucional të forcës shtrënguese të zbatimit të ligjit dhe të luftës kundër piraterisë, si Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Markave dhe Patentave, Gjykatës, përfaqësues të agjencive të administrimit kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të. Gjithashtu ishin të ftuar dhe përfaqësues të subjekteve tregtare dhe operatorë ekonomikë, të cilët konsiderohen si përdoruesit më të mëdhenj të produktit intelektual në vend, sic ishin përfaqësues të TV-kabllorë, botues, prodhues të fonogrameve dhe videogrameve, përfaqësues të televizioneve etj.

Qëllimi kryesor i këtij seminari kombëtar ishte prezantimi i parimeve të përgjithshme të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, në arenën ndërkombëtare, rëndësia dhe përfitimet nga zbatimi i ligjit të së drejtës së autorit, si dhe menaxhimi kolektiv i të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, parimet e përgjithshme, roli i qeverisë, aspektet ekonomike dhe sociale, etj.

Ky seminar pati në fokus gjithashtu dhe rëndësinë e:

- Shkëmbimit të eksperincave të vendeve, të cilat kanë kaluar në mënyrë të ngjashme fazën ku ndodhet vendi ynë sot.
- Mënyrat më efikase për të ndryshuar gjendjen e krijuar nga pirateria, e shndërruar në një industri, industri e cila ka përfshirë vlera financiare të mëdha.
- Informimi dhe kuptimi i mbrojtjes kombëtare dhe ndërkombëtare të të Drejtës të Autorit dhe të Drejtave të tjera të lidhura me të,

- **Mars 2008 -Qershor 2008, Rumani:**

*Dy vizita studimore* janë organizuar në Rumani në Zyrën e të Drejtës së Autorit (ORDA-Zyra Rumune e të Drejtës së Autorit), ku përfaqësues të zyrës sonë kanë përfituar eksperiencën e tyre më të mirë dhe rastet e zgjidhjes së çështjeve, ku kishte shkelje të së drejtës së autorit. Një element i rëndësishëm, që vlen të përmendet në zyrën rumune, ishte bashkëpunimi i ngushtë dhe efektiv i kësaj zyre me hallkat e tjera si polici, prokurori, gjykata. Rumunia është konsideruar nga vendet e rajonit tonë, si një eksperiencë pozitive për t'u ndjekur si shembull, në efikasitetin dhe shpejtësinë e përmirësimit të situatës dhe luftës kundër piraterisë.

- **9-13 qershor 2008, Rumani:**

Pjesëmarrje në Seminarin ndërajonal **”Mbi të Drejtën e Autorit dhe të Drejtave të tjera të lidhura me të”** si dhe për Agjensitë e Administrimit Kolektiv, e cila u zhvillua në Tulcea,/Bukuresht, Rumani nga Zyra Rumune për të Drejtën e Autorit. Seminari u mbështet dhe u financua nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale në bashkëpunimin me Zyrën Rumune për të Drejtën e Autorit. (ORDA)

- **9-10 qershor 2009, Tiranë:**

Një tjetër seminar i renditur në mënyrë kronologjike, por për nga rëndësia dhe tematika vlen të përmendet me prioritet është seminari me temë *“Menaxhimi i të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në mjedisin dixhital”* i organizuar në bashkëpunim me Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe mbështetur financiarisht nga OBPI. Një temë mjaft aktuale në mjedisin e sotëm teknologjik e dixhital, i cili po pëson transformime galopante dita-ditës, ku ndeshemi në pjesën më të madhe me shkelje dhe dhunim të të drejtave të Pronësisë Intelektuale në tërësi.

Qëllimi i këtij seminari ishte prezantim dhe njohje mbi zhvillimet më të fundit në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar, përsa i takon mbrojtjes dhe menaxhimit të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në epokën e dixhitalizimit.

Në këtë seminar kanë qënë të ftuar të marrin pjesë përfaqësues edhe nga institucionet shtetërore të cilat kanë përgjegjësi dhe detyrime konkrete në zbatimin e ligjit për të drejtën e autorit, si KKRT, Tatime, Dogana, Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe e Patentave, Gjykatës, Prokurorë, përfaqësues të agjensive të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, kabllorë, botues, prodhues, përdorues të pronësisë intelektuale, Internet Service Provider (ISP) dhe Content Provider, të cilët aktiviteti i tyre ka të bëjë me sigurimin e linjës së internetit, dhe të cilët kanë detyrime ligjore ndaj ligjit për të drejtën e autorit.

Të ftuar dhe folës gjatë këtij seminari kombëtar ishin personalitete me eksperiencë në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, të tillë si: **Dr. Silke Von LEWINSKI**, eksperte në fushën e PI, Max Institute, Zj, **Carole CROELLA** –këshilltare në Divizionin e ligjit për të drejtën e autorit në WIPO si dhe 2 përfaqësues nga IFRRO (Federata Ndërkombëtare e Organizatave të të drejtave të Riprodhimit) **Zj. Samantha Holman** dhe **Z. Peter Shepherd**.

Fokusi i këtij seminari ishte mjedisi dixhital dhe zhvillimet më të fundit në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të, mbrojtja ndërkombëtare e softwarë-ve, menaxhimi efektiv i të drejtave të autorit në mjedisin dixhital, roli i masave teknologjike të mbrojtjes, përgjegjësia e siguresve të shërbimit të internetit (ISP) në fushën e të drejtës së autorit.

- **7 maj 2009, Kroaci dhe 9-10 nëntor 2009, Izrael**

Në këto dy data janë zhvilluar 2 takime që i takojnë një inisiative shumë të rëndësishme të OBPI. Organizimi i këtyre takimeve (i pari i zhvilluar në maj 2009 në Kroaci) dhe i dyti në radhë i zhvilluar në Izrael, ka për qëllim prezantimin e një studimi i cili është duke u kryer nga dy emra të shquar në fushën e pronësisë intelektuale botërore, siç janë Z. Mihail Ficsor, President i Aleancës për të Drejtën e Autorit të vendeve të Europës Qëndrore dhe Lindore dhe Z. Ivan Bliznet, Rektor i Institutit Shtetëror Rus për Pronësinë Intelektuale.

Ky studim, i finacuar nga OBPI ka për synim kryesisht vendet e Europës Lindore dhe Qendrore, Ballkanin Perëndimor, Rajonin e Kaukazit, dhe Azia Qëndrore dhe synon të bëjë një studim të hollësishëm të situatës aktuale ku këto vende ndodhen, sa i takon të Drejtës së Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me të, si dhe dhënien e sugjerimeve konkrete, që këto vende të mund të ndihmohen në procesin e hartimit apo të adaptimit të kornizës ligjore përkatëse për mbrojtjen e të Drejtave të Autorit e të Drejtave të tjera të lidhura me të, sidomos në kushtet e zhvillimeve të vrullshme të teknologjive të reja e në kushtet e ambientit dixhital.

Fokusi i këtyre workshop-eve ishte i përqëndruar në përshtatjen e ligjeve mbi të drejtën e autorit të Vendeve të këtyre rajoneve për sa i përket teknologjive të reja; Pranimi dhe zbatimi i “Traktateve të Internetit” të OBPI.



## PJESËMARRJE NË AKTIVITETE TË TJERA

- **1-3 prill 2009:**

Një tjetër seminar, ku mori pjesë dhe një përfaqësues i ZSHDA, në kuadër të forcimit të të drejtave të PI është zhvilluar nga UNECE, në kujdesin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjistikës me temë:” *Mbi Tregtimin dhe Forcimin e Pronësisë Intelektuale në kuadër të UNECE-s*”, në Shkup të Maqedonisë.

- **Më datat 27-28 tetor 2009:**

MIE në bashkëpunim me Institutin Ligjor Gjerman “INWENT”, organizoi një seminar/trajnim 2 ditor me temë “Pronësia Intelektuale”, ku ZSHDA-ja prezantoi raportin “*Legjislacioni i së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në RSH*”. Në këtë aktivitet ishin të ftuar përfaqësues të zyrave homologe Kroate dhe Rumune, për të prezantuar eksperiencat përkatëse për mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Gjithashtu, morën pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore: si Autoriteti i Konkurrencës, Shkolla e Magjistraturës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, METE, MTKRS etj.

- **Në datë 11.11.2009:**

Është paraqitur raporti sektorial “*Mbrojtja e së drejtës së autorit dhe e të drejtave të tjera të lidhura me të në RSH gjatë periudhës 2000-2009*”-pjesë e raportit kombëtar për këtë periudhë si dhe është bërë prezantimi i tij para përfaqësuesve të Organizatës Botërore të Tregëtisë (OBT), në takimin e zhvilluar pranë METE-s.

### ❖ MËSHTETJE E KOMISONIT EUROPIAN PËR ZSHDA

(Seminare dhe trajnime )

Zyra Shqiptare e te Drejtës së Autorit, për më shumë se 2 vite të funksionimit të saj, ka ndërmarrë një sërë aktivitetesh në fushën e PI në bashkëpunim me Komisionin European.

Mund të relatojmë për marrëdhënie bashkëpunuese të ngushta me KE dhe me Delegacionin e tij në Tiranë.

- **Dhjetor 2007:**

**Z. Mihaly Fiscor**, një personalitet i shquar në fushën e të Drejtës së Autorit, asistoi Zyrën tonë për të ndarë opinionet e tij dhe për të dhënë sugjerime në amendimin e ligjit dhe përafrimin e legjislacionit tonë me atë të vendeve të BE-së.

Z. Fiscor theksoi se ligji aktualisht në fuqi, për të Drejtën e Autorit ka nevojë për rishikim nga ana e ekspertëve ndërkombëtarë. Kjo vizitë e ekspertit u mundësuar nga Komisioni European dhe Programi i Asistencës Teknike TAIEX.

- **20 Shkurt 2008, Tiranë:**

U zhvillua një workshop në Tiranë me fokus kryesor:

“E Drejta e autorit dhe agjensitë e administrimit kolektiv të të Drejtës së autorit”. Të ftuar në këtë workshop përveç grupeve të ndryshme të interesit, përfaqësues të agjencive të Administrimit Kolektiv, ishin dhe personalitete të fushës së të drejtës së autorit, **Z. Mihaly Fiscor dhe Z. Mitko Chatabalshev** – përfaqësues i CISAC, Drejtor i vendeve të Evropës Juglindore në CISAC (Konfederata Ndërkombëtare e Shoqërisë së Autorëve dhe e Kompozitorëve), një ndër organizmat më të mëdhenj që operojnë në këtë fushë, organizëm, i cili jo në pak raste, për shkak të repertorit shumë të gjerë që përfaqëson (2.5 milionë autorë) ka drejtuar trendin e zhillimit të politikave europiane dhe botërore sa i takon të Drejtës së Autorit.

- **15 Maj 2008, Tiranë**

**“Eksperienca Rumune e të Drejtës së Autorit, si një ndër eksperiencat më të suksesshme.**

Ky Seminar vjen në vazhden e mbështetjes që institucioni i ri Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit ka marrë gjatë këtyre muajve të fundit nga organizma të rëndësishme ndërkombëtare siç janë: Komisioni European dhe Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale.

Në këtë seminar është ftuar të marrë pjesë në cilësinë e ekspertit Drejtoresha e Përgjithshme e Zyrës Rumune për të Drejtën e Autorit, **Znj. Rodika Parvu dhe Zj Anna –Maria Marinescu**, përgjegjëse për fushën e menaxhimit kolektiv të të drejtave pranë Zyrës Rumune.

Jo më kot, në këtë seminar ishte ftuar nga Komisioni European, në cilësinë e organizatorit, Zyra Rumune e të Drejtës së Autorit, pasi kjo zyrë është një ndër eksperiencat më pozitive dhe më efektive të ndryshimit rrënjësor brenda një kohe shumë të shkurtër të situatës së të Drejtës së Autorit në Rumani.

Eksperienca Rumune tregon, që në momentin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale, strategji në të cilën morën detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të gjitha institucionet shtetërore, të cilat konsiderohen pjesë e zinxhirit institucional të zbatimit të pronësisë intelektuale.

Ky seminar në thelb pati si qëllim prezantimin e eksperiencës rumune si të suksesshme, por edhe të prezantimit të nivelit të funksionimit të mbrojtjes së të Drejtës së Autorit në vendet e BE dhe të legjislacionit european dhe ndërkombëtar në përgjithësi.

Në seminar ishin të ftuar përfaqësues të institucioneve shqiptare shtetërore si Dogana, Tatime, KKRT, Policia e Shtetit etj, dhe përfaqësues të komunitetit të autorëve dhe Agjensitë e Administrimit Kolektiv të të Drejtave, si dhe të operatorëve ekonomike, përdorues të produktit intelektual, si TV, Radio, Prodhues CD-DVD,

## □ **Projekte madhore/ Komisioni europian**

### ❖ **IPA 2008- Asitencë teknike**

Në kuadër të Programit **IPA 2008**, projekt i Komisionit Europian (Programimi i IPA 2008 është bërë në bazë të planit për zhvillim dhe integrim, politikave të qeverisë dhe PKZMSA. ) “Forcimi dhe zbatimi i kapaciteteve të ZSHDA-së dhe institucioneve të tjera të përfshira në procesin e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtës së autorit”, është përftuar një fond prej 800.000 Euro, i cili do të përdoret për mbështetjen e ZSHDA-së në funksion të forcimit të saj institucional, si dhe të adresimit të trajnimeve për përfaqësues të strukturave shtetërore dhe gjyqësore, të cilat kanë lidhje të pazgjidhshme në procesin e zbatimit të ligjit.

Si hap i parë i këtij projekti u bë i mundur atashimi i një eksperti të huaj (Z. Pius Alexander Benczek) pranë stafit të ZSHDA-së për hartimin e termave të referencës për fillimin e procedurave të tenderimit ndërkombëtar për zbatimin e këtij projekti.

Eksperti ka kryer takime me të gjithë stafin e zyrës, ka marrë dëgjime për mënyrën se si kjo zyrë funksionon, dhe ka bërë kështu një vlerësim të nevojave dhe të prioriteteve që kjo zyrë ka.

Objektivi i përgjithshëm dhe qëllimi i këtij projekti është të ndihmojë Qeverinë e Shqipërisë në forcimin e sistemit të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të autorit, në përputhje me standardet e BE.

Qëllimi i projektit është forcimi i kapaciteteve të ZSHDA-së dhe Zyrave Rajonale të të drejtës së autorit dhe partnerët e tyre, në zinxhirin e institucioneve që kanë përgjegjësi dhe angazhimet në procesin e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtës së autorit. Nëpërmjet këtij projekti, ne presim të kemi dhe punonjës të trajnuar në ZSHDA dhe në institucionet e reja të vendosura (Zyrat Rajonale të të drejtës së autorit- ZRDA), të aftë të punojnë në këtë fushë, që të vendosin bashkëpunimin dhe marrëdhëniet operative/funksionale me punonjës të tjerë të institucioneve shtetërore, pjesë e zinxhirit të zbatimit (tatimet, doganat, gjyqësia, policia).

### ❖ **IPA RAJONALE :**

*Programi Rajonal mbi të Drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.*

Për të rishikuar ligjin dhe gjithë paketën ligjore në tërësi në fushën e të Drejtës së Autorit, ZSHDA do të përftojë edhe nga një projekt rajonal:

## Programi Rajonal mbi të Drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.

Ky projekt financohet nga Komisioni European në kuadër të IPA 2007 dhe do të zbatohet nga Zyra Europiane e Patentave. Ndër qëllimet kryesore të tij dhe komponenti më i rëndësishëm i tij është harmonizimi i gjithë paketës ligjore në fushën e PI, me të gjitha vendet e përfshira në këtë projekt.

### ❖ **Bashkëpunimi i ZSHDA-së me USAID**

USAID në Shqipëri dhe Programi i tij Cassals & Associates ka qënë një ndër institucionet kryesore, i cili duhet falenderuar për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë ZSHDA-së, sidomos në hapat e parë të krijimit të tij si institucion.

Ka qënë pikërisht kjo organizatë, e cila në formë donacioni , ka bërë pajisjen e ZSHDA-së me pajisje zyrahe dhe me pajisje kompjuterike, duke kapërcyer kështu pengesat për fillimin normal të aktivitetit të ZSHDA-së.

### ❖ **Publikime dhe materiale promociionale, sensibilizuese**

- **Spot televiziv:**

Gjatë vitit 2007, është bërë e mundur nga USAID në Shqipëri dhe Programi i tij Cassals & Associates, *realizimi i një spoti publicitar* me karakter informues e sensibilizues, për të gjithë përdoruesit e PI.

- **Përmbledhje e legjislacionit:**

Gjithashtu mbështetur nga USAID dhe Programi i tij Cassals & Associates, është bërë e mundur *botimi i një përmbledhje të legjislacionit shqiptar* për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të (Ligji – konventat, traktatet, marrëveshjet dhe VKM për krijimin dhe funksionimin e ZSHDA-së.

- **Fletëpalosje informative:**

ZSHDA ka përgatitur *një fletëpalosje informative* mbi Legjislacionin shqiptar për të Drejtën e Autorit në këtë fushë. Kjo fletëpalosje përmban informacion kyç mbi të drejtën e autorit, fushën e mbrojtjes, cilat vepra gëzojnë mbrojtje, cila është kohëzgjatja e mbrojtjes, etj dhe është shpërndarë përmes institucioneve shtetërore dhe jo-shtetërore të cilat kanë përgjegjësi dhe detyrimet e tyre karshi respektimit dhe zbatimit të ligjit për të drejtën e autorit si; KKRT, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencitë e Administrimit Kolektiv të të drejtës së autorit të liçensuara deri më sot si dhe gjithashtu komunitetit të autorëve/ krijues.

- **Libërth për të Drejtën e Autorit:**

ZSHDA ka përkthyer, botuar dhe shpërndarë një libërth komik, me ilustrime për të drejtën e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me të. Ky libër është i destinuar për kategorinë e fëmijëve dhe nxënësve të shkollave. Është një ndër zgjidhjet e sugjeruara sot në botë, që të fillohet informimi dhe edukimi mbi të drejtën e autorit si koncept, që në bankat e shkollës. ZSHDA ka marrë të drejtën e përkthimit, botimit dhe shpërndarjes së libërthit nga OBPI, e cila është botuesja e tij.

- **Të kuptojmë të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të.**

Ky është një libër broshurë i përgatitur nga OBPI, i cili ka informacion sintetik dhe mjaft të vlefshëm për konceptet bazë të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, për të drejtat materiale dhe jo materiale që gëzojnë autorët apo mbajtësit e të drejtave. OBPI i ka dhënë të drejtën ZSHDA-së për përkthimin, botimin dhe shpërndarjen e kësaj vepre në Shqipëri. Botimi i saj u mbështet financiarisht nga Kompania “UNISON”.

### ❖ **MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN**

Zyra ka patur kontakte të vazhdueshme me median e shkruar dhe atë elektronike për të pasqyruar në kohë reale veprimtarinë dhe aktivitetet e saj.

Zyra ka pothuajse se 2 vite, që disponon faqen e saj zyrtare online. Vazhdon mirëmbajtja e faqes zyrtare të web-site ([www.zshda.gov.al](http://www.zshda.gov.al)) të financuar nga OCSE në Tiranë, si dhe furnizimi i kësaj faqeje me materiale informative në lidhje me të drejtën e autorit dhe çështje të tjera të lidhura me të, si dhe pasqyrohen të gjitha aktivitetet e zyrës nga krijimi i saj e deri më sot, për të gjitha grupet e interesuara, komunitetin e autorëve dhe të përdoruesve dhe publikun e gjerë në përgjithësi.

### ❖ **Organizmat Ndërkombëtare dhe Përfaqësitë Diplomatike të akredituar në Tiranë:**

Gjatë këtyre viteve, ky sektor ka hartuar projekte konkrete mbi nevojat dhe prioritetet ZSHDA-së dhe i ka prezantuar pranë strukturave ndërkombëtare që operojnë në Tiranë si psh. Banka Botërore, SOROS, UNDP, OSCE, UNICEF, Save the Children etj. Gjithashtu ka qënë në kontakte të vazhdueshme me përfaqësitë diplomatike të akredituara në Shqipëri, për të prezantuar institucionin e ri ZSHDA, si edhe për të kërkuar vëmendjen e tyre në vendosjen e urave të bashkëpunimit midis ZSHDA-së dhe strukturave respektive shtetërore, që veprojnë në fushën e pronësisë intelektuale, në vëndet respektive.

## ❑ **BUXHETI I MIRATUAR I ZYRËS SHQIPTARE PËR TË DREJTËN E AUTORIT PËR VITET 2007,2008,2009**

Në 000/ lekë

ZSHDA , mbikqyr dhe monitoron respektimin e të drejtave të autorëve dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.	Pagat llog.600	Sigurimet shoqërore llog.601	Shpenzi met operativ e llog.602	Projekt e llog.604	Investim e llog.231	TOTALI
1	2	3	4	5	6	7
VITI 2007	6.537	1.152	2.100	612	8.300	<b>18.701</b>
VITI 2008	7.710	1.510	2.550		1.000	<b>12.770</b>
VITI 2009	10.450	1.650	1.900		400	<b>14.400</b>